



Financat publike vendore Raporti 2023

Maj 2024



REPUBLIKA E SHqipëRISE
MINISTRIA E FINANCAVE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BUXHETIT
DREJTORIA E FINANCAVE VENDORE

FINANCAT PUBLIKE VENDORE RAPORTI 2023

MAJ 2024

Ky raport është përgatitur me mbështetjen e projektit 'Financat Lokale' nga Sekretariati Zviceran i Shtetit për Çështje Ekonomike SECO

FINANCATLOKALE | Forcimi i Menaxhimit
LOCALFINANCES | të Financave Publike
të Qeverisjes Vendore



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Sekretariati Zviceran i Shtetit për Çështje Ekonomike, SECO

Përmbajtja

Përmbledhje ekzekutive.....	9
Hyrje.....	15
Treguesit fiskalë të pushtetit vendor 2023	18
Të ardhurat e pushtetit vendor	24
Të ardhurat e veta	24
Transfertat nga buxheti i shtetit dhe taksat e ndara	31
Transferta e pakushtëzuar sektoriale	32
Taksat e ndara	35
Ecuria e të ardhurave sipas bashkive	37
Shpenzimet e pushtetit vendor	41
Shpenzimet vendore sipas natyrës ekonomike	44
Shpenzimet e NJVQV-ve sipas popullsisë	46
Shpenzimet përkundrejt transfertave dhe të ardhurave të veta	48
Shpenzimet e personelit për numër punonjësish	50
Shpenzimet vendore sipas natyrës funksionale	51
Shpenzimet vendore sipas burimit të financimit	54
Detyrimet e prapambetura	56
Detyrimet e parapambetura ndaj totalit të ardhurave të veta vendore	58
Detyrimet e prapambetura ndaj shpenzimeve vjetore faktike	60
Decentralizimi dhe treguesit fiskalë vendorë krahasuar me vendet e rajonit dhe OECD	62
Përfundime	70
Analiza e treguesve fiskalë sipas njësive të vetëqeverisjes vendore	75
Treguesit e të ardhurave dhe shpenzimeve sipas njësive të vetëqeverisjes vendore	76
Bashkia Belsh.....	76
Bashkia Berat.....	77
Bashkia Bulqizë.....	78
Bashkia Cërrik.....	79
Bashkia Delvinë.....	80
Bashkia Devoll.....	81
Bashkia Dibër.....	82
Bashkia Divjakë.....	83
Bashkia Dropull.....	84
Bashkia Durrës.....	85
Bashkia Elbasan.....	86
Bashkia Finiq.....	88
Bashkia Fier.....	87
Bashkia Fushë-Arrëz.....	89
Bashkia Gjirokastër.....	90
Bashkia Gramsh.....	91
Bashkia Has.....	92
Bashkia Himarë.....	93

Bashkia Kamëz	94
Bashkia Kavajë	95
Bashkia Këlcyrë	96
Bashkia Klos	97
Bashkia Kolonjë	98
Bashkia Konispol	99
Bashkia Korçë	100
Bashkia Krujë	101
Bashkia Kuçovë	102
Bashkia Kukës	103
Bashkia Kurbin	104
Bashkia Lezhë	105
Bashkia Libohovë	106
Bashkia Librazhd	107
Bashkia Lushnjë	108
Bashkia Malësi e Madhe	109
Bashkia Maliq	110
Bashkia Mallakastër	111
Bashkia Mat	112
Bashkia Memaliaj	113
Bashkia Mirditë	114
Bashkia Patos	115
Bashkia Peqin	116
Bashkia Përmet	117
Bashkia Pogradec	118
Bashkia Poliçan	119
Bashkia Përrenjas	120
Bashkia Pukë	121
Bashkia Pustec	122
Bashkia Rrogozhinë	123
Bashkia Roskovec	124
Bashkia Sarandë	125
Bashkia Selenicë	126
Bashkia Shijak	127
Bashkia Shkodër	128
Bashkia Skrapar	129
Bashkia Tepelenë	130
Bashkia Tiranë	131
Bashkia Tropojë	132
Bashkia Dimal	133
Bashkia Vau i Dejës	134
Bashkia Vlorë	135
Bashkia Vorë	136
Analiza e buxheteve sipas Këshillave të Qarqeve	137
Këshilli i Qarkut Berat	137
Këshilli i Qarkut Dibër	137
Këshilli i Qarkut Durrës	138
Këshilli i Qarkut Elbasan	138

Këshilli i Qarkut Fier.....	139
Këshilli i Qarkut Gjirokastrë.....	139
Këshilli i Qarkut Kukës.....	140
Këshilli i Qarkut Lezhë.....	140
Këshilli i Qarkut Shkodër.....	141
Këshilli i Qarkut Tiranë.....	141
Këshilli i Qarkut Vlorë.....	142
Këshilli i Qarkut Korçë.....	142

LISTA E FIGURAVE

Figura 1 Të ardhurat e veta vendore dhe Shpenzimet e buxhetit vendor në raport me totalin e të ardhurave publike dhe shpenzimeve publike dhe PBB në vite.....	20
Figura 2 Krahasimi i planit të rishikuar vendor dhe realizimit faktik vjetor 2023 të të ardhurave dhe shpenzimeve sipas treguesve fiskalë.....	22
Figura 3 Trendi mujor i të ardhurave dhe shpenzimeve diskrecionare të pushtetit vendor gjatë vitit 2023.....	23
Figura 4 Të ardhurat nga burimet e veta dhe ecuria e ndryshimit në vite.....	24
Figura 5 Të ardhurat e veta vendore ndaj të ardhurave të përgjithshme publike dhe PBB-së në vite.....	25
Figura 6 Të ardhurat tatimore dhe jotatimore vendore 2018 - 2023.....	25
Figura 7 Struktura e të ardhurave të veta vendore.....	26
Figura 8 Të ardhurat e veta vendore sipas burimit dhe rritja vjetore 2022 - 2023.....	27
Figura 9 Të ardhurat e veta vendore në vite sipas burimit.....	27
Figura 10 Pësia e bashkive sipas madhësisë në disa nga burimet kryesore të të ardhurave vendore 2023.....	28
Figura 11 Taksa e pasurisë në vite.....	29
Figura 12 Taksa e pasurisë zërave kryesorë.....	29
Figura 13 Përbërja e të ardhurave nga taksat mbi pasurinë në vitin 2023, sipas bashkive.....	30
Figura 14 Transferta e pakushtëzuar dhe sektoriale në vite, dhe kundrejt PBB.....	32
Figura 15 Ndarja e transfertës sektoriale 2023 (buxheti fillestar).....	32
Figura 16 Transferta e pakushtëzuar e përgjithshme dhe sektoriale në raport me të ardhurat e veta (pa Tiranën).....	34
Figura 17 Ndryshimi vjetor i të ardhurave nga taksat e ndara sipas bashkive, 2023/2022.....	36
Figura 18 Ndryshimi i të ardhurave të veta vendore sipas bashkive 2023/2022.....	37
Figura 19 Të ardhurat e veta për banor sipas bashkive, 2022 dhe 2023 (lekë).....	39
Figura 20 Të ardhurat për banor nga transferata e pakushtëzuar, taksat e ndara dhe të ardhurat e veta.....	40
Figura 21: Shpenzimet e pushtetit vendor në vite dhe ritmi vjetor i rritjes.....	41
Figura 22 Pësia e shpenzimeve vendore ndaj PBB-së dhe shpenzimeve të përgjithshme publike.....	42
Figura 23 Ndryshimi i shpenzimeve sipas bashkisë 2023/2022.....	43
Figura 24 Shpenzimet 2023 sipas klasifikimit ekonomik (milionë lekë).....	44
Figura 25 Pësia e bashkive në shpenzime sipas madhësisë dhe natyrës ekonomike.....	45
Figura 26 Shpenzimet mesatare për banor sipas burimit të financimit 2023.....	46
Figura 27 Shpenzimet mesatare për banor sipas natyrës ekonomike e madhësisë së bashkisë.....	46
Figura 28 Shpenzimet për banor sipas natyrës ekonomike dhe bashkive.....	47
Figura 29 Shpenzimet kapitale dhe për personelin përkundrejt të ardhurave të veta.....	49
Figura 30 Shpenzimet kapitale dhe për personelin përkundrejt transfertës së pakushtëzuar e sektoriale.....	49
Figura 31 Numri i punonjësve gjithsej dhe për 1000 banorë sipas bashkive.....	50
Figura 32 Pësia e shpenzimeve sipas natyrës funksionale 2023 dhe 2022.....	52
Figura 33 Pësia e shpenzimeve sipas natyrës së funksioneve të pushtetit vendor sipas bashkive, 2023.....	53
Figura 34 Struktura e shpenzimeve vendore sipas burimit të financimit 2023.....	54
Figura 35 Struktura e shpenzimeve sipas bashkive dhe burimeve të financimit.....	55

Figura 36 Detyrimet e prapambetura të pushtetit vendor në vite.....	57
Figura 37 Pesha e detyrimeve të prapambetura të pushtetit vendor sipas natyrës.....	57
Figura 38 Detyrimet e prapambetura ndaj të ardhurave të veta, 2023.....	59
Figura 39 Detyrimet e prapambetura ndaj shpenzimeve vjetore sipas bashkive 2023.....	60
Figura 40 Transfertat ndërqeveritare ndaj PBB-së (2013 – 2022).....	64
Figura 41 Transfertat ndërqeveritare ndaj shpenzimeve publike (2013 – 2022).....	65
Figura 42 Shpenzimet vendore ndaj PBB-së (2013 – 2022).....	66
Figura 43 Shpenzimet vendore ndaj shpenzimeve të përgjithshme publike 2013 - 2022.....	67
Figura 44 Të ardhurat e veta vendore ndaj PBB-së (2013 – 2022).....	68
Figura 45 Të ardhurat e veta vendore ndaj të ardhurave të përgjithshme publike (2013 – 2022).....	69

LISTA E SHKURTIMEVE

MF	Ministria e Financave
AFMIS	Albanian Financial Management Information System
NJVQV	Njësi të Vetëqeverisjes Vendore
PBB	Produkti i Brendshëm Bruto
OECD	Organisation for Economic Co-operation and Development
SIFQ	Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë
PBA	Programi Buxhetor Afatmesëm
PBB	Prodhimi i Brendshëm Bruto



Përmbledhje ekzekutive



Krjimi i një pushteti vendor të fortë financiarisht por edhe me kapacitete njerëzore të qëndrueshme është një tregues i rëndësishëm që siguron cilësi në standardin e jetesës së qytetarëve. Treguesit fiskalë të vitit 2023, evidentojnë qartë rritjen e qëndrueshme të të ardhurave dhe shpenzimeve të pushtetit vendor. Thellimi i decentralizimit dhe sigurimi i shërbimeve vendore të një cilësie sa më të lartë mbetet objektiv kryesor.

Në raport me treguesit kombëtarë të pushtetit vendor për vitin 2023, në këtë analizë janë evidentuar treguesit kryesorë fiskalë dhe të autonomisë si më poshtë:

- Shpenzimet e pushtetit vendor për vitin 2023 janë rreth 10.2% e shpenzimeve të përgjithshme publike dhe 3.0 % e Prodhimit të Brendshëm Bruto. Krahasuar me trendin e një viti më parë, në raport me shpenzimet e përgjithshme publike, shpenzimet vendore janë rritur me 1.18% dhe po ashtu janë rritur me rreth 0.23%, ndaj PBB-së.

Shpenzimet e pushtetit vendor janë rritur ndjeshëm edhe në vlerë nominale në vitin 2023, duke arritur **68.8 miliardë lekë**, ose rreth **17 % më shumë** se një vit më parë. Të ardhurat e veta vendore të realizuara gjatë vitit 2023 arritën 34.95 miliardë lekë ose rreth 51% të burimeve të përgjithshme vendore, duke qenë rreth 4 miliardë lekë më shumë se një vit më parë.

- Të ardhurat e veta vendore (taksat, tarifrat dhe të ardhurat jotatimore vendore) janë rreth 4.9% e të ardhurave publike, me një peshë rreth 0.1% më të lartë se në vitin 2022. Gjithashtu, pushteti vendor ka rritur rolin e tij në vite përmes kontributit në ekonomi duke ndryshuar raportin e të ardhurave të veta vendore nga 0.82% e PBB në vitin 2015, në 1.37 % në vitin 2023. Megjithë rritjen e PBB prej rreth 8.1% në raport më të lartë se një vit më parë, të ardhurat e pushtetit vendor për 2023 zënë 1.37% të PBB nga 1.29% që ishin në vitin 2022 (sipas të dhënave të përditësuara), duke reflektuar kështu edhe rritjen e rolit të pushtetit vendor në drejtim të shërbimeve publike dhe funksioneve që ushtron.
- Në vitin 2023, pushteti vendor ka përfituar në formën e **transfertës së pakushtëzuar së përgjithshme dhe sektoriale rreth 33.87 miliardë lekë, ose rreth 15.8% më shumë se një vit më parë.**
- Pushteti vendor ka marrë rreth 2.25 miliardë lekë në vitin 2023 nga taksat kombëtare të ndara, nga tatimi i të ardhurave personale (51%); taksa e regjistrimit të automjeteve (42%) dhe renta minerare (7%), ose 11% më shumë se në vitin paraardhës. Rritja më e lartë është regjistruar për tatimin e të ardhurave personale, ndërsa ka pasur rënie në të hyrat nga renta minerare.
- Në vitin 2023 është mbështetur financiarisht rritja e pagave sipas vendimeve përkatëse të Këshillit të Ministrave, për punonjësit e funksioneve sektoriale me një fond prej 400 milion LEK (për funksionin e arsimit parashkollor (edukatorë + punonjës në Qendrat Kulturore të Fëmijëve+punonjës mbështetës), për funksionin e arsimit parauniversitar, funksionin e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit, për funksionin e ujitjes dhe kullimit dhe për funksionin e administrimit të pyjeve).
- Është mbështetur financiarisht nga buxheti qendror rritja e pagave për pushtetin vendor sipas Vendimit nr.328 datë 31.5.2023 të Këshillit të Ministrave “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore,

për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore”, me një fond prej 743.1 milion LEK.

- Pushteti vendor ka realizuar rreth **16.56 miliardë lekë shpenzime për investime në vitin 2023** të cilat në raport me shpenzimet e pushtetit vendor zënë rreth 24%, kurse në raport me të ardhurat e veta vendore (tatimore dhe jotatimore) këto shpenzime zënë 47%.
- Nga analiza e shpenzimeve mujore të vitit 2023, konstatohet që vetëm në 2 muajt e fundit janë realizuar rreth **11.5 miliardë lekë shpenzime ose 17%** të totalit të shpenzimeve vjetore të pushtetit vendor.
- Stoku i detyrimeve të prapambetura në fund të muajit dhjetor 2023, është rreth **4.8 miliardë lekë**, me një rënie prej rreth 600 milionë lekë nga viti 2022.
- Stokun më të lartë të detyrimeve të prapambetura e ka Bashkia Kavajë në vlerën rreth **793 milion lekë**, e cila përbën 16.7% të totalit të detyrimeve. Ndërkohë në nivel vendor peshën më të madhe të stokut të detyrimeve e zë **kategoria “Investime” me 47%**. Stoku i **detyrimeve të prapambetura zë rreth 7% të totalit të faktit të shpenzimeve të njësive të vetëqeverisjes vendore.**

Një aspekt i rëndësishëm janë të ardhurat e pushtetit vendor për vitin 2023, si rrjedhojë në këtë analizë janë evidentuar treguesit e të ardhurave sipas burimit për pushtetin vendor:

- Pushteti vendor ka mbledhur të ardhura të veta rreth **34.9 miliardë lekë, nga të cilat rreth 31.7 miliardë lekë, ose 91% e zënë të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore dhe pjesa tjetër prej 3.2 miliardë lekë ose 9%** janë të ardhurat jotatimore të pushtetit vendor.
- Në vitin 2023, pushteti vendor konsolidoi trendin e rritjes së të ardhurave të veta **me rreth 3.9 miliardë lekë ose rreth 12.9% më shumë se një vit më parë.**
- Burimi me peshën më të madhe në të ardhurat vendore gjatë vitit 2023, **është taksat e ndikimit mbi infrastrukturë me rreth 37.3% të të ardhurave të veta vendore.** Pavarësisht se në nivel agregat ky burim është më i rëndësishmi për pushtetin vendor, **në nivel njësie rreth 72% e mbledh vetëm Bashkia Tiranë.**
- Taksat e pasurisë përbëjnë 17.7% të të ardhurave të veta vendore (6.2 miliardë lekë), ndërkohë që taksat mbi ndërtesën zë rreth **76% të totalit të të ardhurave nga taksat mbi pasurinë.** Taksat e ndërtesës në vitin 2023 është rritur me 200 milionë lekë (4%) ndaj një viti më parë, ndërsa taksat e tokës bujqësore është rritur me 33 milionë lekë (6%). Bashkia Tiranë realizon 47% të të ardhurave nga taksat e pasurisë në nivel kombëtar, ndërsa gjashtë bashkitë e mëdha (Durrës, Elbasan, Shkodër, Fier, Vlorë e Kamëz) realizojnë 22%.
- Kapaciteti dhe performanca fiskale e bashkive ndryshon shumë në varësi të madhësisë së popullsisë dhe kontekstit ekonomik. Bashkia Tiranë realizoi 56% të gjithë të ardhurave të veta vendore në nivel agregat, dhe Tirana së bashku me gjashtë bashkitë më të mëdha sipas popullsisë – Durrës, Elbasan, Shkodër,

Fier, Vlorë e Kamëz, realizuan tre të katërtat e të gjithë të ardhurave të veta vendore.

- **Të ardhurat e veta vendore janë rritur në 38 bashki në krahasim me një vit më parë, por janë pakësuar në 23 bashki.**
- Bashkitë me rënien më të madhe të të ardhurave të veta janë **bashkitë Belsh, Skrapar, Kukës e Memaliaj (mbi 20% rënie vjetore); ndërsa bashkitë më rritjen më të madhe të të ardhurave të veta janë Poliçani dhe Pusteci.**
- Peshën më të madhe në rritjen e të ardhurave të veta në vitin 2023 e mban bashkia Tiranë, me një rritje vjetore prej 2.3 miliardë lekë, ose 57% e rritjes vjetore të të ardhurave të veta agregate. Rritja në gjashtë bashkitë e tjera të mëdha (Durrës, Elbasan, Fier, Kamëz, Shkodër, Vlorë) prej 0.9 miliardë lekësh përbën 23% të rritjes vjetore.
- Dhjetë bashkitë më një popullsi nga **50 mijë-100 mijë banorë, që përbëjnë 21% të popullsisë,** kanë mbledhur vetëm 3.5 miliardë lekë ose 10% të totalit të të ardhurave vendore.
- Bashkitë me **nën 50 mijë banorë (44 bashki me 31% të popullsisë) kanë mbledhur vetëm 5.1 miliardë lekë në vitin 2023, ose 15% të totalit të të ardhurave të pushtetit vendor.**
- **Pushteti vendor në vitin 2023 mesatarisht ka mbledhur 5,708 lekë për banorë,** ose 11% më shumë në krahasim me vitin 2022.
- **Të ardhurat më të larta për banor janë realizuar në bashkinë Himarë, me 43.8 mijë lekë për banor, e ndjekur nga Tirana (30.6 mijë lekë/banorë); Saranda (22.7 mijë lekë/banorë), Kamza (14.7 mijë lekë/banorë).** Bashkitë me mbi 100 mijë banorë kanë realizuar mesatarisht 7.3 mijë lekë të ardhura për banor (18% rritje); bashkitë e mesme me 50 – 100 mijë banorë kanë mbledhur mesatarisht 5 mijë lekë për banor (10% rritje nga 2022) dhe bashkitë e vogla kanë mbledhur gjithashtu mesatarisht 5 mijë lekë për banor (10% rritje). Bashkitë bregdetare Himarë dhe Sarandë kanë të ardhura shumë të larta për banor për shkak të të hyrave nga taksa e ndikimit në infrastrukturë.

Treguesit e shpenzimeve vendore gjatë vitit 2023 janë një aspekt i rëndësishëm i menaxhimit financiar, ku më poshtë janë evidentuar disa nga pikat kryesore të këtyre treguesve:

- Në vlerë absolute buxheti vendor ka realizuar **68.8 miliardë lekë, ose rreth 10.1 miliardë lekë** apo 17.3 % më shumë shpenzime krahasuar me vitin 2022.
- Shpenzimet e personelit zënë rreth **43.1% të totalit të shpenzimeve vendore,** në një peshë pothuajse të njëjtë me një vit më parë, por me rreth **4.5 miliardë lekë më shumë.**
- Shpenzimet për investime gjatë vitit 2023 zënë rreth **24.1% të totalit të shpenzimeve vendore.** Në raport me një vit më parë konstatohet që **shpenzimet për investime** kanë një **rritje me mbi 4.6 miliardë lekë ose 39%** dhe pesha relative e investimeve në strukturën buxhetore është rritur me 4%.

- Shpenzimet operative në vitin 2023, prej 19.4 miliardë lekë, zënë rreth **28.1% të totalit të shpenzimeve vendore**, në ulje të peshës relative në krahasim me vitin 2022, por **me një rritje të lehtë në vlerë nominale**.
- Zgjerimi i hapësirës fiskale për bashkitë gjatë vitit 2023 për shkak të rritjes së transfertave, taksave të ndara dhe të ardhurave të veta është fokusuar kryesisht në rritjen e shpenzimeve për paga (42% e rritjes) dhe investime (44% e rritjes).
- Pushteti vendor ka financuar në pjesën më të madhe të buxhetit funksionin e **“Çështjeve ekonomike”**; **“Shërbimeve të përgjithshme publike”** dhe **“Arsimit”**, përkatësisht në masën **21%**; **20%** dhe **19%**
- Vetëm **9 bashki nga totali kanë patur një rënie të shpenzimeve në vitin 2023 në raport me shpenzimet e realizuara në vitin 2022**. Bashkitë me rënien më të madhe janë bashkitë **Kukës, Roskovec e Konispol me një rënie prej 10-11% dhe bashkitë Dropull, Dimal, Kavajë dhe Shijak me rënie 5-8%** të shpenzimeve.
- Bashkitë me rritjen më të madhe të shpenzimeve gjatë vitit 2023 janë **bashkia Librazhd dhe Përmet (47% rritje) ndjekur nga Kamza (42%); Vau i Dejës (36%) dhe Saranda (32%)**.
- **Rreth 32%** të totalit të shpenzimeve të buxhetit vendor e zë Bashkia Tiranë. Bashkitë Durrës, Elbasan, Fier, Kamëz, Shkodër dhe Vlorë së bashku zënë 12% të shpenzimeve vendore (14.8 miliardë lekë së bashku). 10 bashkitë me popullsi mes 50 dhe 100 mijë banorë, gjatë vitit 2023 kanë shpenzuar rreth **11 miliardë lekë ose rreth 16%** të totalit të shpenzimeve të pushtetit vendor.
- Shpenzimet e personelit (paga dhe sigurime) janë mesatarisht 9,9 mijë lekë për banor në nivel agregat; në bashkitë e vogla (nën 50 mijë banorë) shpenzimet e personelit rriten në 10.6 mijë lekë për banor, ose 8% më shumë se mesatarja.
- Shpenzimet për investime për banor janë 4.4 mijë lekë mesatarisht për të gjitha bashkitë. Ato janë më të larta në bashkinë Tiranë (dyfishi i mesatares kombëtare) dhe mesatarisht më të ulëta në dhjetë bashkitë e mesme, me 50 – 100 mijë banorë. Shpenzimet më të larta për banor për investime i ka kryer bashkia Himarë (23.4 mijë lekë) dhe bashkia Përmet (11.7 mijë lekë).

Treguesit pozitivë të financave vendore gjatë vitit 2023 dëshmojnë për konsolidimin gradual të reformës dhe rritjes së cilësisë së menaxhimit financiar nëpërmjet zbatimit me sukses nga të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore të procedurave të hartimit të PBA-së, zbatimit të buxhetit dhe standardeve të monitorimit të realizimit të buxhetit vendor. Për vitet në vijim, fokusi kryesor do të jetë në disa drejtime:

- a. Rritja në vijim e mbështetjes së dhënë nga buxheti qendror për pushtetin vendor në formën e transfertave (transferta e pakushtëzuar dhe sektoriale).
- b. Përmirësimi i menaxhimit të financave vendore nëpërmjet përmirësimit të performacës së realizimit të të ardhurave të veta.
- c. Shpërndarja e Tatimit mbi të Ardhurat Personale duke u dhënë mundësi financiare shtesë njëjësive të vetëqeverisjes vendore për të amortizuar vështirësitë dhe rritur efektshmërinë e shërbimeve.

- d. Reforma e iniciuar nga Ministria e Financave në taksën e pasurisë është pasqyruar në rritjen e të ardhurave të pushtetit vendor nga kjo taksë, ndonëse rritja ka pësuar ngadalësim të ritmit vitet e fundit, në pritje të finalizimit të kadastrës fiskale.
- e. Konsolidimi i procedurave dhe sistemi i menaxhimit të financave vendore në të gjithë etapat, që nga hartimi i programit buxhetor afatmesëm tek zbatimi dhe monitorimi i tij; harmonizimi dhe unifikimi i procedurave për hartimin, zbatimin, raportimin, monitorimin e buxheteve të njërive të vetëqeverisjes vendore, në përputhje me standardet ndërkombëtare;
- f. Zbatimi i metodologjisë për hartimin e programit buxhetor afatmesëm në nivel produkti buxhetor, përmes plotësimit online të softit Ssitemi i Menaxhimit të Buxhetit Vendor;
- g. Prezantimi dhe përdorimi i treguesve të performancës në PBA dhe ndikimi pozitiv në rritjen e cilësisë së monitorimit të zbatimit të buxhetit vendor;
- h. Monitorimi i vazhdueshëm i treguesve fiskalë të zbatimit të buxhetit, në funksion të zbatimit të politikave buxhetore që do të rrisin efikasitetin dhe efektshmërinë e përdorimit të fondeve publike në nivel vendor;
- i. Hartimi i raporteve periodike të menaxhimit të vështirësive financiare, si një detyrim ligjor për të monitoruar situatën financiare të njërive të vetëqeverisjes vendore; publikimi i raportit vjetor: “Mbi statusin e vështirësive financiare të njërive të vetëqeverisjes vendore”;
- j. Asistenca e drejtpërdrejtë ndaj njërive të vetëqeverisjes vendore, në të gjitha hapat e menaxhimit financiar në nivel vendor përmes komenteve dhe konsultimit jo vetëm të hartimit të programit buxhetor afatmesëm, por edhe të raportit të monitorimit të zbatimit të buxhetit;
- k. Realizimi i trajnimeve, takimeve dhe konsultimeve të vazhdueshme me njësitë e vetëqeverisjes vendore në kuadër të masave të marra nga Ministria e Financave për menaxhimin financiar në nivel vendor, si një hap parapërgatitor për zbatimin e sistemit AFMIS në nivel vendor në një periudhë afatmesme.
- l. Procesi i monitorimit të detyrimeve të prapambetura do të vazhdojë periodikisht edhe në vitin 2024, duke zbatuar me përpikmëri detyrimet ligjore dhe nënligjore mbi statusin e vështirësive financiare të njërive të vetëqeverisjes vendore.
- m. Niveli i lartë i fondeve të papërdorura në një vit buxhetor dhe trashëgimi i tyre në buxhetin e vitit pasardhës, është një tjetër problematikë e evidentuar gjatë vitit 2023. Bashkitë duhet të përmirësojnë kapacitetet e tyre në parashikimin e të ardhurave dhe të shpenzimeve dhe parashikimin e likuiditeteve për shpenzime.



Hyrje



Gjatë vitit 2023 pushteti vendor ka bërë progres të dukshëm në konsolidimin e menaxhimit financiar, por gjithashtu edhe në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve në nivel vendor. Analiza e treguesve financiarë të vitit 2023 dhe krahasimi me ecurinë në vite paraqet një pamje shumë dimensionale të të gjithë komponentëve të menaxhimit financiar në nivel vendor dhe sipas njësive të vetëqeverisjes vendore. Fokusi i këtij raporti do të jetë vlerësimi i kapacitetit fiskal të pushtetit vendor, cilësia e planifikimit dhe realizimit të shpenzimeve apo problematikat e tjera si detyrimet e prapambetura apo fondet e trashëguara, të cilat kanë impakt të drejtpërdrejtë në qëndrueshmërinë financiare. Ministria e Financave paraqet në këtë raport rezultatet zyrtare dhe analizën e treguesve financiarë të pushtetit vendor për vitin 2023.

Reformat e zhvilluara në vite për modernizimin e financave vendore, kanë dhënë rezultate në përmirësimin e cilësisë së treguesve fiskalë, por nga ana tjetër edhe problematika të cilat ky raport i identifikon qartë. Gjatë vitit 2023, pushteti vendor ka treguar aftësi të mira për konsolidimin financiar dhe përmirësimin metodologjik të hartimit, zbatimit dhe monitorimit të buxhetit vendor. Rikthimi i rritjes ekonomike ndikoi në përmirësimin e situatës financiare të njësive të vetëqeverisjes vendore.

Në mbështetje të strategjisë kombëtare të decentralizimit dhe në zbatim të parimeve të Kartës Europiane të Autonomisë Vendore, Ministria e Financave ka punuar për të forcuar rolin financiar të pushtetit vendor, duke konsoliduar cilësinë e administrimit fiskal të njësive të vetëqeverisjes vendore. Në këtë drejtim, tashmë pas 7 viteve nga miratimi i kuadrit ligjor për menaxhimin financiar në nivel vendor, do të analizojmë ecurinë në nivel vendor të reformave fiskale por edhe gjendjen financiare të njësive të vetëqeverisjes vendore.

Raporti është organizuar në tre pjesë. Pjesa e parë dhe e dytë analizojnë ecurinë e të ardhurave dhe shpenzimeve vendore gjatë vitit 2023, përfshirë një vështrim krahasues me vendet e rajonit. Në seksionin e tretë paraqiten të dhëna të hollësishme për të ardhurat dhe shpenzimet për secilën bashki.

Ky raport u përgatit me mbështetjen e projektit “Financat Lokale”. Të gjitha të dhënat janë marrë nga Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë. Raporti analizon të gjitha të ardhurat dhe shpenzimet e njësive të vetëqeverisjes vendore mbi të cilat ato kanë autonomi vendimmarrjeje për qëllimin dhe mënyrën e përdorimit (brenda standardeve ligjore dhe parimeve të mirëadministrimit fiskal), pra të ardhurat nga burime të pakushtëzuara si të ardhurat e veta, transfertat e pakushtëzuar dhe sektoriale dhe taksat e ndara; si dhe shpenzimet që njësitë e vetëqeverisjes vendore kryejnë nga këto burime. Në këtë raport nuk përfshihen dhe analizohen fondet e kushtëzuara për funksionet e deleguara nga pushteti qendror tek ai vendor me ligj apo marrveshje. Të dhënat e popullsisë i referohen “popullsisë efektive”. Në vitet e fundit ndryshimet strukturore të ekonomisë dhe lëvizjet e kapitalit njerëzor kanë shfaqur problematika edhe për burimet e njësive të qeverisjes vendore dhe kërkesës për shërbime në territorin e tyre. Për efekt të përlllogaritjes së transfertës së pakushtëzuar dhe efektit financiar, Ministria e Financave u referohet shifrave të popullsisë nga dy burime të ndryshme: censusi më i fundit (2011) dhe të dhënave administrative të gjendjes civile. Ndryshimet strukturore në njësitë e vetëqeverisjes vendore pas lëvizjeve të mëdha demografike kanë sjellë nevojën për të korriguar, për efekt financiar, të dhënat e popullsisë nga censusi, për të reflektuar kostot fikse që disa bashki vijnë të kenë në territor pavarësisht zvogëlimit të popullsisë. Për përlllogaritjen e shpërndarjes së

financave ndërqeveritare, përmes ligjit vjetor të buxhetit është përdorur një kriter korigjues me termin “Banorë rezidentë efektivë,” i cili korigjon diferencat e këtyre dy burimeve të të dhënave në shpërndarjen e popullsisë ndërmjet bashkive. Në këtë rast treguesi i popullsisë përlogaritet me formulën:

$$\text{Banorë rezidentë efektivë} = [\text{CENSUS} + (\text{Regjistri i gjendjes civile} - \text{Census}) * 30\%]$$

Në këtë drejtim, për të ulur riskun e argumenteve në të dy rastet, në këtë seksion të analizës janë përdorur koncepti i banorë rezidentë efektivë si për të ardhurat ashtu edhe për shpenzimet e njësive të vetëqeverisjes vendore.



Treguesit fiskalë të pushtetit vendor 2023



Qeveria e Shqipërisë ka identifikuar decentralizimin dhe forcimin e njësive të vetëqeverisjes vendore (NJVQV) si një prioritet kritik të politikave publike. Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian (SKZHI) 2022-2030 identifikon objektivin për “Rritjen e autonomisë financiare vendore nëpërmjet konsolidimit të sistemit të të ardhurave të veta”. Strategjia Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore dhe Plani i Veprimit (2023-2030) ka gjashtë objektiva kyç, me synimin e përgjithshëm për ndërtimin e qeverisjes vendore efektive, të qëndrueshme dhe me ndikim zhvillimor. Një objektiv ambicioz i strategjisë së decentralizimit është rritja e transfertave të qeverisë qendrore drejt pushtetit vendor, në përputhje me mesataren e BE-së, si dhe përmirësimi i performancës financiare i njësive të vetëqeverisjes vendore. Po ashtu, Strategjia Kombëtare e Menaxhimit të Financave Publike (2024 – 2030, draft) thekson përmirësimet e rëndësishme në performancën financiare të qeverisjes vendore në vitet e fundit. Prioritetet e decentralizimit fiskal dhe menaxhimit financiar vendor sipas strategjisë së financave publike janë harmonizuar me objektivat e politikave në kuadër të Strategjisë së Decentralizimit. Strategjia e MFP-së thekson përparësitë e mëposhtme për periudhën 2023-2026:

- Përshtatja e formulës së transfertës së pakushtëzuar, për shkak të ndryshimit të të dhënave të censusit 2023 për numrin e popullsisë si dhe rishikimit të kritereve në bazë të këtyre rezultateve.
- Përmirësimi i proceseve për zbatimin dhe monitorimin e buxhetit, si dhe përgatitjes së PBA-së.
- Forcimi i sistemeve të menaxhimit të financave publike dhe informacionit financiar përmes përdorimit të AFMIS në nivel vendor.
- Përgatitja e kadastrës fiskale dhe sistemit të mbledhjes së tatimit të pasurisë, për zbatim të plotë në periudhën pas vitit 2026 – duke përfshirë plotësimin e kuadrit ligjor dhe rregullator, finalizimin e kadastrës fiskale me ndërveprueshmërinë dhe integrimin me sistemet e tjera.


Cjatë vitit 2023, Ministria e Financave ka ndjekur me përparësi jo vetëm ecurinë e hartimit të programit buxhetor afatmesëm dhe zbatimin e buxhetit me raportet periodike për monitorimin e tij, por edhe ecurinë e të ardhurave të veta vendore dhe shpenzimeve në nivelin e njësive të vetëqeverisjes vendore. Përmes ndjekjes së ecurisë së treguesve fiskalë është siguruar ruajtja e qëndrueshmërisë financiare por edhe monitorimi i mbulimit me fondet e nevojshme financiare të funksioneve të përcaktuara me ligj. Analiza e treguesve fiskalë të pushtetit vendor shërben jo vetëm për paraqitjen zyrtare të të dhënave, por edhe për të evidentuar shkallën e përmbushjes së objektivave të qeverisë në raport me decentralizimin dhe mirëqeverisjen.

Raporti i shpenzimeve publike ndaj Prodhimit të Brendshëm Bruto në Shqipëri është relativisht i ulët, në rreth 29.2%. Në një kontekst ku përmasa e sektorit publik (fiskal) është relativisht e përmbajtur, është e natyrshme që pesha e shpenzimeve të njësive të qeverisjes vendore është gjithashtu relativisht modeste. Megjithatë, pesha e të ardhurave dhe shpenzimeve vendore ndaj sektorit publik është rritur gradualisht gjatë dekadës së fundit, duke dëshmuar për rritjen e rëndësisë së pushtetit vendor. Në vitin 2023, shpenzimet e pushtetit vendor (të financuar me burime nga transfertat e pakushtëzuar e përgjithshme dhe sektoriale, taksat e ndara dhe të ardhurat e veta tatimore dhe jotatimore) përfaqësonin 10.2% të shpenzimeve të përgjithshme

publike, në nivele të krahasueshme me vitet 2017 – 2019. Efekti i shokut ekonomik të krizave të vitit 2019 – 2021, si pasojë e tërmetit 2019, pandemisë e më tej rritjes së papritur të çmimeve e efekteve inflacioniste në ekonomi, të cilat tkurrën të ardhurat e për rrjedhojë edhe shpenzimet e përgjithshme publike, u ndjenë më pak në nivelin vendor, për shkak të natyrës së të ardhurave të veta vendore dhe ruajtjes së niveleve të financimit me grante nga buxheti i shtetit. Në këto vite, pavarësisht ngadalësimit të rritjes së shpenzimeve, pesha e shpenzimeve të njësisive të qeverisjes vendore ndaj shpenzimeve të përgjithshme publike u rrit, për t’u stabilizuar sërish gjatë vitit 2022 në rreth 9.02% dhe në vitin 2023 në nivelin 10.2%. Në terma nominale nveli i shpenzimeve për pushtetin vendor për vitin 2023 arriti në masën rreth 68.8 miliardë LEK, nga 58.7 miliardë LEK një vit më parë. Kjo përfaqëson një rritje prej 10.1 miliardë LEK ose rreth 17.3% në krahasim me shpenzimet vendore të vitit 2022 dhe një rritje të lehtë prej 0.23% në raport me PBB, që dëshmon se gjatë vitit 2023, luhatjet e ardhura nga efektet negative të disa viteve më parë tashmë janë stabilizuar dhe proceset e menaxhimit financiar publik në nivel vendor vazhduan në trendin pozitiv, gjë që dëshmohet edhe nga rritja e shpenzimeve të buxhetit vendor në krahasim me vitin 2022. Në vitin 2023, shpenzimet e pushtetit vendor zënë rreth 3% të PBB nga 2.7% që ishin në 2022.

Gjatë dhjetë viteve të fundit, ritmi vjetor i rritjes së të ardhurave të veta tatimore të pushtetit vendor (ritmi mesatar vjetor 11.9%) ka qenë përgjithësisht më i lartë se ai i rritjes së të ardhurave të përgjithshme publike (ritmi mesatar vjetor 7.2%). Pesha e të ardhurave vendore ndaj PBB-së është rritur gjithashtu nga 0.8% të PBB-së në vitin 2013, në 1.02% në 2016 – vitin e parë të zbatimit të reformës territoriale e transferimit të funksioneve të reja vendore; deri në 1.37% të PBB-së në vitin 2023 megjithë rritjen e PBB prej rreth 8.1% në raport më të lartë se një vit më parë. Në mënyrë grafike ecuria e të ardhurave të veta tatimore të pushtetit vendor në raport me të ardhurat e përgjithshme publike dhe PBB në 10 vitet e fundit e po ashtu shpenzimet e pushtetit vendor në raport me totalin e shpenzimeve publike dhe PBB në 10 vitet e fundit, paraqiten në grafikun e mëposhtëm:

Figura 1 Të ardhurat e veta vendore dhe Shpenzimet e buxhetit vendor në raport me totalin e të ardhurave publike dhe shpenzimeve publike dhe PBB në vite



Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave (2024)

Ecuria e treguesve fiskalë të pushtetit vendor gjatë vitit 2023, ka rezultuar pozitive si në mbledhjen e të ardhurave ashtu edhe në ecurinë e realizimit të shpenzimeve për financimin e funksioneve të përcaktuara me ligj. Gjatë vitit 2023, njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë kryer shpenzime totale (nga burimet e veta, transfertat e pakushtëzuara dhe sektoriale dhe fondet e trashëguara) në masën 68.8 miliardë lekë ose 17.3% më shumë se në vitin 2022.

Ecuria e **të ardhurave të veta** gjatë vitit 2023 ishte mjaft pozitive, duke vijuar trendin rritës të viteve të fundit. Njësitë e qeverisjes vendore kanë realizuar **34.9 miliardë lekë** të ardhura të veta, ose 12.9% rritje ndaj vitit paraardhës (30.9 miliardë lekë); nga të cilat taksat dhe tarifat vendore arrijnë në rreth **31.7 miliardë lekë** (91 përqind) dhe 3.3 miliardë lekë (9 përqind) vijnë nga të ardhurat jotatimore. Forcimi i kapacitetit fiskal të njësive të vetëqeverisjes vendore është një objektiv i rëndësishëm i realizuar në kuadër të krijimit të njësive vendore të forta financiarisht. Realizimi i të ardhurave të veta nga taksat dhe tarifat vendore e ka tejkaluar planin e të ardhurave në buxhetin fillestar 2023 me rreth 9% dhe me rreth 14% planin e të ardhurave buxhetin e rishikuar.

Transfertat e buxhetit qendror janë një burim shumë i rëndësishëm i financimit të pushtetit vendor. Transfertat nga buxheti i shtetit mbeten një burim thelbësor për të garantuar qëndrueshmërinë financiare dhe ushtrimin e funksioneve vendore. Në vitin 2023, pushteti vendor ka përfituar në formën e **transfertave rreth 33.87 miliardë lekë, ose rreth 15.8% më shumë se një vit më parë**. Ndër transfertat për pushtetin vendor, të caktuara me buxhetin vjetor, njësitë e qeverisjes vendore kanë përfituar 23.98 miliardë lekë për transfertën e pakushtëzuar të përgjithshme dhe 9.9 miliardë për transfertat sektoriale. Gjithashtu në vitin 2023 është mbështetur financiarisht nga buxheti qendror rritja pagave për pushtetin vendor në masën 1,141.3 milion lekë.


Financimi i huaj për pushtetin vendor në vitin 2023 është realizuar në masën 526 milionë lekë nga të cilat kanë përfituar financim 6 qarqe për rreth 46 milionë lekë dhe 34 bashki me rreth 480 milionë lekë .

Në vitin 2023, transfertat e pakushtëzuar e përgjithshme dhe sektoriale përbëjnë 51% të buxhetit vendor të planifikuar në nivel të ngjashëm me një vit më parë, por më të lartë me peshën që patën në vitin 2022, kur këto transfertat zinin 47.6% të buxhetit vendor të planifikuar. Transfertat e pakushtëzuar dhe sektoriale u rritën përkatësisht me 4.6 miliardë lekë më shumë në 2023. Ndonëse transfertat janë rritur të mënyrë të qëndrueshme në vlerë nominale, pesha e tyre në të ardhurat e përgjithshme vendore nga burime të pakushtëzuara është moderuar disi për shkak të rritjes më të shpejtë të ardhurave të veta. Referuar realizimit faktik të të ardhurave të veta vendore dhe shpenzimeve të buxhetit vendor për vitin 2023, të ardhurat e veta vendore në vitin 2023 përbëjnë 50.8 % të burimeve të financimit të pushtetit vendor, një tregues pozitiv që dëshmon për thellimin e autonomisë fiskale vendore.

Taksat e ndara, ku përfshihen tatimi mbi të ardhurat personale, taksa e regjistrimit të automjeteve dhe renta minerare, janë një burim tjetër i rëndësishëm për të ardhurat e njësive të vetëqeverisjes vendore. Në vitin 2023, 2.25 miliardë lekë u transferuan në buxhetin e njësive të qeverisjes vendore nga taksat e ndara (11% më shumë se në vitin 2022), ose 3.3% e të ardhurave vendore, me një rritje të ndjeshme nga viti 2022 veçanërisht për tatimin e të ardhurave personale (28 përqind më shumë).

Shpenzimet e njësisve të vetëqeverisjes vendore kanë njohur gjithashtu rritje domethënëse gjatë vitit 2023 krahasuar me vitin paraardhës. **Plani i shpenzimeve prej 66.5 miliardë lekë për pushtetin vendor** në treguesit fiskalë të buxhetit të rishikuar, i cili duke reflektuar edhe shtesat që ka marrë buxheti vendor nga rritja e pagave prej 1,143.1 milionë lekë, si dhe 86 milionë lekë bashkëfinancime të bashkive për projektet e huaja, financuar drejtëpërdrejtë nga MF dhe SASPAK, e çon planin e shpenzimeve të pushtetit vendor në 67.7 miliardë lekë. Realizimi faktik i shpenzimeve është tejkaluar duke u realizuar faktikisht 68.8 miliardë lekë. Në mënyrë të drejtëpërdrejtë ky realizim është kontribuar nga rritja e realizimit të të ardhurave të veta vendore me 14.2% më shumë se plani rishikuar 2023. Rritja e cilësisë së menaxhimit financiar në nivel vendor është reflektuar edhe në nivelin e realizimit të shpenzimeve kapitale, jo vetëm në rritjen e shpenzimeve ku njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë realizuar 17.3%, ose mbi 10.1 miliardë lekë më shumë shpenzime se në vitin 2022, ndër të cilat 4.6 miliardë lekë është dedikuar për më shumë investime.


Figura 2 Krahasimi i planit të rishikuar vendor dhe realizimit faktik vjetor 2023 të të ardhurave dhe shpenzimeve sipas treguesve fiskalë



Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave (2024)

Realizimi i të ardhurave dhe shpenzimeve përgjatë vitit buxhetor ka një shpërndarje ciklike 4 mujore. Realizimi i të ardhurave përshpejtohet në muajt prill/maj dhe nëntor. Megjithatë në vitin 2023, realizimi i të ardhurave të veta vendore pati një stepje në muajt e parë, por vazhdoi me ritme të larta në muajt e fundit të vitit. Sa u përket shpenzimeve, dy muajt e parë të vitit kanë nivelet më të ulëta të shpenzimeve, ndërkohë që në vijim shpenzimet vendore kanë ruajtur një trend të qëndrueshëm mujor, megjithatë, në muajin e fundit të vitit konstatohet një kapërcim jo normal i trendit të shpenzimeve me rreth 11.5 miliardë lekë shpenzime ose 16.7% të totalit të shpenzimeve që pushteti vendor ka realizuar gjatë gjithë vitit. Ruajtja e trendit të ciklit 3 apo 6 mujor të realizimit të të ardhurave të veta vendore i shërben uljes së riskut të pushtetit vendor në menaxhimin financiar publik. Në këtë kuadër është e rëndësishme të shmangët dukuria e përqëndrimit të shpenzimeve në fund të vitit, kryesisht të lidhura me likuidimin e investimeve. Respektimi i planit të detajuar mujor të shpenzimeve dhe disiplinimi për shpërndarjen në kohë të shpenzimeve ul probabilitetin për krijimin e detyrimeve të prapambetura, të cilat janë të lidhura kryesisht me investimet e pashlyera. Ndryshimet e shpeshta të planit të shpenzimeve dhe likuiditeteve gjatë vitit janë tregues i qartë i riskut potencial që ka menaxhimi financiar i njësisve të vetëqeverisjes vendore ku ndodh ky fenomen.

Figura 3 Trendi mujor i të ardhurave dhe shpenzimeve diskrecionare të pushtetit vendor gjatë vitit 2023



Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave (2024)


Të ardhurat e pushtetit vendor

Të ardhurat e veta

Rritja e të ardhurave të veta vendore në kuadër të konsolidimit të ecurisë së decentralizimit dhe ruajtja e qendrueshmërisë së transfertave të buxhetit qendror në vitin 2023 krijoi kushtet e favorshme për një pjesë të konsiderueshme të njësisve të vetëqeverisjes vendore për të nxitur politika të reja në drejtim të rritjes së cilësisë së shërbimeve publike. Duke marrë në konsideratë rëndësinë që kanë burimet e financimit të pushtetit vendor, për përmirësimin e jetës së qytetarëve, në këtë seksion janë analizuar burimet kryesore të të ardhurave të njësisve të vetëqeverisjes vendore nga burime të pakushtëzuara.

Në vitin 2023, pushteti vendor ka mbledhur nga taksat dhe tarifatat vendore **rreth 31.7 miliardë lekë dhe të ardhura jokatimore rreth 3.3 miliardë lekë, ose në total rreth 34.9 miliardë lekë të ardhura të veta**. Ritmi vjetor i rritjes së të ardhurave të veta është përshpejtuar në vitin 2023, periudhë gjatë së cilës njësitë e qeverisjes vendore kanë mbledhur 12.9% më shumë të ardhura të veta në krahasim me një vit më parë, ose rreth 3.9 miliardë lekë më shumë. Pushteti vendor në këtë mënyrë ka konsoliduar ecurinë pozitive të rritjes së burimeve të veta të financimit të shërbimeve që ofron për komunitetin. Ky trend pozitiv referuar treguesve fiskalë të buxhetit të shtetit pritet të ruhet nga pushteti vendor edhe gjatë vitit 2024.

Figura 4 Të ardhurat nga burimet e veta dhe ecuria e ndryshimit në vite




Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave (2024)

Një aspekt i rëndësishëm i menaxhimit financiar në nivel vendor është krahasimi i të ardhurave të veta vendore me të ardhurat publike dhe produktin e brendshëm bruto. Gjatë vitit 2023, të ardhurat e veta vendore arritën rreth 4.92% të të ardhurave publike dhe rreth 1.37% të Produktit të Brendshëm Bruto, çka dëshmon për një rritje të të ardhurave të veta jo vetëm në vlerë absolute, por edhe si peshë relative ndaj treguesve kombëtarë. Gjithashtu, kjo rritje e ndjeshme është e lidhur edhe me përshpejtimin e rritjes ekonomike, e ndikuar kryesisht nga sektorë si ndërtimi dhe shërbimet. Pjesa më e madhe e rritjes së të ardhurave është arritur nga rritja shumë domethënëse e taksës së ndikimit në infrastrukturë (73% e rritjes); dhe rritja e taksave

të tjera (hoteli, pasuria, të tjera) dhe tarifës së pastrimit.¹ Përqendrimi i burimeve të veta në një sasi të kufizuar taksash e tarifash tregon varësinë ndaj ecuresë ekonomike në sektorë të caktuar dhe nevojën për diversifikim më të mirë të burimeve, në veçanti shfrytëzimit më të mirë të tarifave të shërbimeve, për të mbuluar kostot e lëvrimit të shërbimeve më cilësore e më gjithëpërfshirëse.


Figura 5 Të ardhurat e veta vendore ndaj të ardhurave të përgjithshme publike dhe PBB-së në vite



Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave (2024)

Të ardhurat jotatimore, ku përfshihen kryesisht të ardhura nga qiraja dhe shitja e aseteve; të hyra nga ndërmarrjet vendore publike dhe gjobat e kundërvajtjet administrative, përbëjnë rreth 9.3% të të ardhurave të veta vendore në vitin 2023. Në vlerë absolute, të ardhurat jotatimore në vitin 2023 janë pothuaj të njëjtat si në vitin 2022 (3.26 miliardë kundrejt 3.31 miliardë në 2022-shin); ndërkohë që kanë një rënie në peshën relative, për shkak të rritjes së lartë të të ardhurave nga taksat e tarifat vendore.

Figura 6 Të ardhurat tatimore dhe jotatimore vendore 2018 - 2023




Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave (2024)

1. Shih seksionin Ecuria e të ardhurave sipas bashkive për një analizë më të detajuar të ecuresë së burimeve specifike dhe shpërndarjes sipas bashkive.

Burimet më të rëndësishme në strukturën e të ardhurave të veta vendore në nivel kombëtar janë taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja (37%); ndjekur nga taksat e pasurisë (18%), tarifa e pastrimit (13%) dhe të ardhurat jotatimore (9%).

Figura 7 Struktura e të ardhurave të veta vendore




Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave (2024)

Kjo strukturë është e ngjashme me atë të vitit 2022, kur taksa e ndikimit në infrastrukturë zinte 33% të të ardhurave, taksat e pasurisë 20% dhe tarifa e pastrimit 15%. Burimet kryesore të të ardhurave janë rritur në vlerë absolute, ndonëse pesha relative e tyre në strukturën e të ardhurave ka ndryshuar lehtësisht. Taksa e fjetjes në hotel ka përjetuar rritjen më të lartë vjetore kundrejt vitit paraardhës, me 41% (408 milionë lekë në 2023 kundrejt 290 milionë në 2022), ndjekur nga taksa e ndikimit në infrastrukturë me 29% rritje (13 miliardë përkundrejt 10.1 miliardë në 2022) dhe “taksa të tjera”, 21% rritje. Performanca në rritjen e të ardhurave nga taksat e pasurisë në vitin 2023 nuk ka shumë ndikim në të ardhurat vendore, duke qënë në të njëjtat nivele


në tre vitet e fundit, përkatësisht në shumën 6.18 miliardë në vitin 2023, 6.14 miliardë në vitin 2022 dhe 6.12 miliardë në vitin 2021. Pothuajse në të gjitha bashkitë, taksat e tarifave vendore zënë peshën më të madhe të të ardhurave, me përjashtim të bashkive Poliçan dhe Pustec, ku të ardhurat jotatimore përbëjnë më shumë se tre të katërtat e të ardhurave të veta.

Figura 8 Të ardhurat e veta vendore sipas burimit dhe rritja vjetore 2022 - 2023



Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave (2024)

Figura 9 Të ardhurat e veta vendore në vite sipas burimit




Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave (2024)

Burimi me peshën më të madhe në të ardhurat vendore gjatë vitit 2023, është taksa e ndikimit në infrastrukturë me rreth 37% të të ardhurave të veta vendore, duke tejkaluar vitin 2022 në vlerë nominale me 2.9 miliardë lekë dhe në peshë relative 4% (33% në vitin 2022). Pavarësisht se në nivel agregat ky burim është më i rëndësishmi

për pushtetin vendor, 72% e të ardhurave nga kjo taksë realizohen në bashkinë Tiranë; ndërsa 87% në Tiranë dhe gjashtë bashkitë më të mëdha të vendit. Taksa e ndikimit në infrastrukturë përbën 48% të të ardhurave të veta në Tiranë, 65% në Kamëz, 52% në Kavajë, 49% në Himarë dhe 39% në Vorë dhe Sarandë. Ky burim të ardhurash nuk siguron qëndrueshmëri financiare në kohë, ndonëse zgjeron bazën e taksave të ndërtesës për të ardhmen.

Pavarësisht ecurisë pozitive të realizimit të të ardhurave të veta, gjatë vitit 2023 vijoi të konsolidohet përqendrimi i fuqisë fiskale në bashkinë Tiranë dhe disa nga bashkitë me popullsinë më të madhe në vend. Bashkia Tiranë realizoi 56% të të gjithë të ardhurave të veta vendore, në nivel kombëtar në vitin 2023. Për më tepër, tre të katërtat e gjithë të ardhurave të veta vendore në vitin 2023 u përqendruan në bashkinë Tiranë dhe gjashtë bashkitë me popullsinë më të madhe në vend – Durrës, Elbasan, Fier, Shkodër, Vlorë dhe Kamëz. Në bashkitë e mesme dhe të vogla pesha e të ardhurave të veta në strukturën e buxhetit është më e ulët, duke rritur varësinë ndaj financimeve nga buxheti i shtetit. Përqendrimi i të ardhurave të veta në një numër të vogël bashkish nënvizon pabarazitë e theksuara midis bashkive të ndryshme, të cilat lidhen jo vetëm me çështje strukturore të ekonomisë e kontekstit vendor por në disa raste edhe me kapacitetet vendore për të përmirësuar performancën fiskale.

Figura 10 Pesha e bashkive sipas madhësisë në disa nga burimet kryesore të të ardhurave vendore 2023



Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave (2024)

Një ndër burimet më të rëndësishme si në këndvështrimin e peshës që ato zënë në totalin e të ardhurave të veta vendore, por gjithashtu edhe të qëndrueshmërisë e potencialit në rritje si burim financimi, janë të ardhurat nga taksat mbi pasurinë e paluajtshme. Gjatë vitit 2023, pushteti vendor ka realizuar 6.18 miliardë lekë të ardhura nga tatimi mbi pasurinë, ku përfshihen taksa e ndërtesës (76%), taksa e tokës bujqësore (10%), taksa e truallit (4%) dhe taksa për transaksionet e pasurisë të paluajtshme (10%).

Taksat e ndërtesës zë 13% të të ardhurave të përgjithshme vendore, me një realizim prej 4.7 miliardë lekë në 2023, përkundrajt 4.5 miliardë në 2022. Mesatarja kombëtare nuk është larg peshës së taksës së ndërtesës në shumicën e bashkive: në mbi gjysmën e bashkive, të ardhurat nga taksa e ndërtesës janë më pak se 12% e të ardhurave të veta. Në bashkinë Roskovec, mbi 60% e të ardhurave të veta gjenerohen nga taksa e ndërtesës. Siç u përmend më lart, performanca e bashkive në mbledhjen e taksave të pasurisë ka vend për përmirësim, siç dëshmohet nga nivele pothuajse të barabarta të hyrash nga taksa e pasurisë në tre vitet e fundit. Për më tepër, niveli i taksës së ndërtesës është gjithashtu larg planit të parashikuar në buxhetin fillestar 2023, me një realizim prej vetëm 89%. Taksimi i pronës mbetet një sfidë e rëndësishme për konsolidimin fiskal të njëjësive të vetëqeverisjes vendore.

Figura 11 Taksa e pasurisë në vite






Figura 12 Taksa e pasurisë zërave kryesore



Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave (2024)

Në vitin 2023, më pak se gjysma e bashkive kanë tejkaluar nivelet taksës së pasurisë së paluajtshme të vitit 2022; ndër këto tetë bashki kanë një rritje vjetore mbi 20% (Bulqizë, Himarë, Klos, Lushnjë, Peqin, Përmet, Sarandë, Tepelenë). Peshën më të madhe në të gjitha bashkitë e ka taksa mbi ndërtesën, në gjashtë prej tyre kjo e fundit përbën mbi 90% të të ardhurave nga taksa e pasurisë (Bulqizë, Gramsh, Kamëz, Kukës, Kurbin, Mat). Taksa e tokës bujqësore është burimi më i rëndësishëm i taksës së pasurisë në 16 bashki, ku pesha e taksës së tokës bujqësore luhetet nga 53% (Cërrik dhe Lezhë), në mbi 80% (Devoll, Memaliaj, Selenicë) të gjithë taksave të pasurisë.

Figura 13 Përbërja e të ardhurave nga taksat mbi pasurinë në vitin 2023, sipas bashkive



Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave (2024)

Pas zerimit të tatim fitimit mbi biznesin e vogël nga viti 2016, pushteti vendor në vite ka akumuluar gjithnjë dhe më pak të ardhura nga ky burim. Në vitin 2023, të ardhurat nga ky burim, të cilat lidhen vetëm me detyrimet e prapambetura të bizneseve, janë 60 milion lekë, vlerë kjo shumë e vogël krahasuar me vitet 2010 – 2015, kur taksa e biznesit të vogël sillte mesatarisht 2.1 miliardë lekë në vit të ardhura.


Një rol të rëndësishëm për pushtetin vendor kanë edhe të ardhurat nga tarifa të ndryshme që mblihen për shërbime të dhëna drejtpërdrejt qytetarëve. Rreth 26% të totalit të të ardhurave të veta vendore në 2023, ose 9 miliardë lekë janë mbledhur nga tarifat vendore, ose 0.2 miliardë lekë më shumë se një vit më parë. Rritja e të ardhurave nga këto shërbime janë tregues i qartë i numrit në rritje të qytetarëve që përfitojnë nga shërbimet vendore. Krahasuar me vitin 2016, vitin e parë të reformës territoriale, bashkitë kanë trefishuar të ardhurat nga tarifat vendore, të cilat shërbejnë për të mbuluar kostot e shërbimeve direkte.

Pas taksës së ndikimit në infrastrukturë dhe taksave të pasurisë, burimi i tretë më i rëndësishëm i të ardhurave të veta vendore është tarifa e pastrimit e higjienës me rreth 4.76 miliard lekë të mbledhura gjatë vitit 2023, me një rritje të lehtë nga një vit më parë me rreth 140 milion lekë (3.5%).

Transfertat nga buxheti i shtetit dhe taksat e ndara

Transferta e pakushtëzuar e përgjithshme dhe sektoriale përbën një burim të rëndësishëm për financimin e funksioneve të pushtetit vendor. Gjatë vitit 2023, pushteti vendor ka përfituar nga buxheti qendror në total rreth 33.87 miliardë lekë në formën e transfertave, nga të cilat rreth 23.98 miliardë lekë ose afërsisht 71% është transferata e pakushtëzuar e përgjithshme, e cila shpërndahet përmes formulës dhe pjesa tjetër prej 9.8 miliardë lekë, ose 29% është në formën e transfertës së pakushtëzuar sektoriale për financimin e funksioneve të transferuara në nivel vendor. Në përputhje me ligjin e financave vendore, transferata e pakushtëzuar ka ruajtur nivelin e 1% të PBB-së në këto vite. Në vitin 2023, transferata e pakushtëzuar në buxhetin fillestar prej 21.76 miliardë lekësh u rrit me rreth 2.2 miliardë lekë gjatë vitit buxhetor (Akti normativ 14 dhjetor 2023). Kjo transfertë shtesë u akordua kryesisht me qëllim shlyerjen e detyrimeve të prapambetura. Referuar këtyre shifrave dhe Produktit të Brendshëm Bruto sipas Aktit normativ të dhjetorit 2023, transferata e pakushtëzuar e përgjithshme për vitin 2023 zë 1.1 % të Produktit të Brendshëm Bruto, duke plotësuar kështu edhe një kusht të rëndësishëm të BE në programin e mbështetjes buxhetore 'BE për Qeverisjen e Mirë (EU4GG), në përmbushjen e treguesve për disbursimin e transhit të katërt, referuar vlerësimit për vitin 2023 për Shqipërinë. Po ashtu edhe sipas të dhënave makroekonomike të përditësuara së fundmi, transferata e pakushtëzuar e përgjithshme akorduar për njësitë e vetëqeverisjes vendore për vitin 2023 zë 1.04% të PBB, duke zënë kështu një përqindje më të lartë krahasuar me vitet e fundit.

Figura 14 Transferta e pakushtëzuar dhe sektoriale në vite, dhe kundrejt PBB




Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave (2024)

Transferta e pakushtëzuar sektoriale

Për funksionet e transferuara me ligj, nga viti 2016 e në vazhdim, bashkitë **përfitojnë një mbështetje buxhetore nga qeveria qendrore në formën e transfertës së pakushtëzuar sektoriale**. Në vitin 2023 transferta e pakushtëzuar sektoriale ishte në vlerën rreth **9.8 miliardë lekë, ose ndryshe rreth 537 milion lekë më shumë se një vit më parë ose sa 29% e fondeve të transfertave të pakushtëzuara gjithsej**. Në raport me të ardhurat e veta të njëjësive të vetëqeverisjes vendore (**34.9 miliardë lekë**), transferta e pakushtëzuar sektoriale është **rreth 33%**.

Figura 15 Ndarja e transfertës sektoriale 2023 (buxheti fillestar)




Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave (2024)

Pjesa më e madhe e transfertes sektoriale financon sektorin e arsimit: në buxhetin fillestar për vitin 2023, 4.5 miliardë lekë (42% e transfertave sektoriale) u shpërnda për personelin mësimor në arsimin parashkollor, në pëputhje me formulën e shpërndarjes në bazë të numrit të fëmijëve dhe mësuesve. Pjesa tjetër financon kostot e stafit mbështetës në arsimin parashkollor (10%) dhe arsimin parauniversitar (5%); si dhe për të mbuluar kostot e konvikteve të arsimit parauniversitar në disa bashki të vendit (5%). 1.4 miliardë lekë janë akorduar për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri për 61 bashkitë, 994 milionë lekë për infrastrukturën e ujitjes dhe kullimit në 61 bashki dhe 700 milionë lekë për menaxhimin e mbetjeve në 30 bashki.

Bashki të vogla dhe me kapacitet të ulët fiskal si Hasi, Këlcyra, Libohova, Memaliaj e Klosi kanë një raport mjaft të lartë të transfertave të përgjithshme dhe sektoriale ndaj totalit të të ardhurave vendore 85 deri në 11 herë më të lartë për transfertën e pakushtëzuar të përgjithshme dhe 3 deri në 6 herë më të lartë për sektorialen. Kjo tregon pamundësinë fiskale që këto njësi kanë për të ushtruar funksione të decentralizuara pa mbështetje buxhetore. Këto bashki që kanë një vlerë të lartë të këtij raporti tregojnë që pjesën e konsiderueshme të funksioneve që ato aktualisht ushtrojnë e mbulojnë përmes transfertës së buxhetit qendror. (Figura 16)

Njësitë e vetëqeverisjes vendore të cilat klasifikohen si të mëdha nga pikëpamja e popullsisë (dhe buxhetit 2023), kanë një raport më të ulët të transfertës së pakushtëzuar sektoriale me të ardhurat e veta. Ulja e këtij raporti është një sfidë në bashkitë e vogla, në drejtim të nxitjes së rritjes së të ardhurave të veta vendore dhe kapacitetit fiskal që këto njësi kanë në raport me autonominë për të ushtruar funksionet që kanë në bazë të përcaktimeve ligjore. Megjithatë, ka edhe njësi mesatare nga pikëpamja e popullsisë që kanë nivel të ulët të të ardhurave të veta, si Kurbin, si edhe bashki të vogla si Himara, Vora e Roskoveci, të cilat kanë të ardhura të veta të larta për shkak të strukturës ekonomike në njësitë përkatëse. Për bashkinë Tiranë, transfertat nga buxheti i shtetit përbëjnë 22% të buxhetit të përgjithshëm nga burimet e pakushtëzuara, ndër këto 7% konsistojnë në transfertat sektoriale.

Figura 16 Transferta e pakushtëzuar e përgjithshme dhe sektoriale në raport me të ardhurat e veta (pa Tiranën)



Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave (2024)


Taksat e ndara

Taksat e ndara, të cilat u transferohen bashkive në përputhje me realizimin e të ardhurave nga taksa e regjistrimit të automjeteve, tatimi i të ardhurave personale dhe renta minerare, përbëjnë një burim të konsiderueshëm të ardhurash. Në vitin 2023, të hyrat nga tatimi i të ardhurave personale (1.15 miliardë lekë) u rrit me 28% në total krahasuar me një vit më parë (0.9 miliardë lekë), si rezultat i rritjes së të hyrave nga kjo taksë në nivel kombëtar. Të ardhurat nga taksa e regjistrimit të automjeteve ishin në nivele të krahasueshme me vitin 2022, ndërsa të ardhurat nga renta minerare u pakësuan me 33%, si pasojë e rënies së çmimeve të mineraleve gjatë vitit 2023. Taksat e ndara përbëjnë mesatarisht 4.3% të buxhetit të përgjithshëm të bashkive (nga burimet e pakushtëzuara), me përjashtim të bashkive si Kurbin, Patos apo Roskoveci ku të ardhurat nga renta minerare janë relativisht të larta, për shkak të aktivitetit minerar në këto bashki, ku në total e pesha e taksave të ndara arrin në rreth 10 – 16%.

Të ardhurat nga taksat e ndara në vitin 2023 janë pakësuar në katër bashki, e në veçanti në bashkitë Patos dhe Roskovec (përkatësisht 28 dhe 27 përqind ulje), për shkak të uljes së të ardhurave nga renta minerare e cila pothuajse është përgjysmuar në krahasim me vitin 2022. Të ardhurat nga renta minerare janë rritur në bashkitë Vlorë, Mat, Kurbin, Klos, Malësi e madhe dhe Berat në vitin 2023, në krahasim me 2022.

Bashkitë me rritjen më të madhe të të ardhurave nga taksat e ndara janë Shkodra, Tropoja dhe Skrapari, ku tatimi i të ardhurave personale pothuajse është dyfishuar.

Figura 17 Ndryshimi vjetor i të ardhurave nga taksat e ndara sipas bashkive, 2023/2022




Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave (2024)

Transferta e pakushtëzuar e përgjithshme dhe sektoriale, së bashku me taksat e ndara, financime të drejtëpërdrejta nga buxheti qendror në atë vendor, përbëjnë burimin kryesor të burimeve në pjesën më të madhe të bashkive.

Ecuria e të ardhurave sipas bashkive

Të ardhurat e veta vendore kanë rezultuar me rritje në pjesën më të madhe të bashkive. Gjatë vitit 2023, **të ardhurat e veta vendore janë rritur në 38 bashki, por janë pakësuar në 23 bashki.**

Figura 18 Ndryshimi i të ardhurave të veta vendore sipas bashkive 2023/2022




Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave (2024)

Bashkitë me rënien më të madhe të të ardhurave janë bashkitë Belsh, Skrapar, Kukës e Memaliaj (mbi 20% rënie), disa prej të cilave kanë patur një rritje të konsideueshme në vitin paraardhës. Bashkitë me **rritjen më të lartë janë Poliçani dhe Pusteci, ndjekur nga Kamza, Patosi, Saranda, Lezha dhe Kavaja (mbi 30%).**

Të ardhurat për banor nga të ardhurat e veta vendore kanë ndryshime të mëdha midis bashkive. Të ardhurat më të larta për banor nga të ardhurat e veta vendore realizohen në disa nga bashkitë e mëdha të vendit (Tiranë, Kamëz, Vlorë); si dhe në disa nga bashkitë bregdetare, në veçanti Himarë, e cila ka të ardhurat më të larta për frymë në të gjithë vendin, ndjekur nga Saranda he Kavaja. Në të gjitha këto bashki, peshën më të madhe të të ardhurave e zë taksa e ndikimit në infrastrukturë. Bashkitë e vogla dhe më rurale kanë tipikisht të ardhura të veta më të ulëta për banor.


Figura 19 Të ardhurat e veta për banor sipas bashkive, 2022 dhe 2023 (lekë)



Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave (2024)

Siç është përmendur më lart, të ardhurat nga transferta e pakushtëzuar kanë një rëndësi thelbësore për buxhetet bashkiake dhe rishpërndajnë disa nga burimet kombëtare drejt bashkive me potencial më të ulët fiskal. Bashkitë me të ardhura të veta më të ulëta dhe/ose bashkitë e vogla ose rurale përfitojnë mesatarisht më shumë të ardhura për frymë nga transferta e pakushtëzuar se bashkitë e mëdha.

Figura 20 Të ardhurat për banor nga transferta e pakushtëzuar, taksat e ndara dhe të ardhurat e veta



Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave (2024)


Nga këto tregues, evidentohet qartë që të ardhurat e veta vendore janë të pabalancuara në nivelin e njësive të vetëqeverisjes vendore, duke sjellë në vëmendje nevojën për ndërhyrje me politika të reja të cilat do të ulnin këto diferenca në përputhje me kushtet specifike të tyre.

Përmirësimi i performancën fiskale vendore dhe krijimi i mekanizmave të rishpërndarjes së të ardhurave, për të shmangur thellimin e zbalancimit fiskal të pushtetit vendor, janë politika të rëndësishme të cilat duhen vlerësuar për t'u zbatuar në të ardhmen e afërt.

Shpenzimet e pushtetit vendor

Shpenzimet e njësive të qeverisjes vendore me burim financimi (të ardhurat e veta, transferata e pakushtëzuar e përgjithshme dhe sektoriale dhe taksat e ndara) gjatë vitit 2023 kanë arritur në 68.8 miliardë lekë, 17% ose 10.1 miliardë lekë më shumë se në vitin paraardhës. Konsolidimi i buxhetit vendor në një trend të qëndrueshëm rritjeje është një tregues i rëndësishëm i qëndrueshmërisë financiare të njësive të vetëqeverisjes vendore.


Figura 21: Shpenzimet e pushtetit vendor në vite dhe ritmi vjetor i rritjes



Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave (2024)

Në fund të vitit 2023, në raport me PBB shpenzimet e buxhetit vendor arritën në **2.98% të Produktit të Brendshëm Bruto dhe 10.2% të shpenzimeve të përgjithshme publike. Krahasuar me një vit më parë, gjatë vitit 2023 shpenzimet e pushtetit vendor janë rritur lehtësisht në raport me PBB-në (0.23%)** (sipas të dhënave të përditësuara) kjo për faktin se shpenzimet vendore janë rritur në raport më të lartë se rritja e vetë PBB nga viti i kaluar. Referuar peshës së shpenzimeve vendore ndaj atyre publike ato paraqiten me rritje me 1% më shumë pra nga 9% në vitin 2022 në 10.2% në vitin 2023.

Figura 22 Pesha e shpenzimeve vendore ndaj PBB-së dhe shpenzimeve të përgjithshme publike




Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave (2024)

Ky raport është një ndër treguesit më të rëndësishëm që shpreh jo vetëm rolin e pushtetit vendor por gjithashtu edhe shkallën e decentralizimit fiskal të pushtetit vendor. Për të përmirësuar këto raporte duhen shtuar mekanizmat financiarë që sigurojnë garanci të shtuar edhe në rritjen e aftësisë së njësive të vetëqeverisjes vendore në ofrimin e shërbimeve publike.

Duke marrë në analizë ndryshimin në shpenzimet e pushtetit vendor nga vitit 2022 në vitin 2023, sipas njësive të vetëqeverisjes vendore konstatohen diferencat e dhëna si në grafikun e mëposhtëm. Në vitin 2023, konstatohet qartë se ka vazhduar rimëkëmbja e ekonomisë, kjo gjë reflektohet edhe në buxhetet individuale të bashkive, shumica e të cilave ka qenë në rritje. Vetëm **9 bashki nga totali kanë patur një rënie të shpenzimeve në vitin 2023 në raport me shpenzimet e realizuara në vitin 2022**. Bashkitë me rënie më të madhe janë bashkitë Kukës, Roskovec dhe Konsipol, me rënie 10 -11% në krahasim me një vit më parë, bashkitë Dropull, Dimal, Kavajë dhe Shijak më rënie 5 – 8% nga një vit më parë, si dhe Devolli dhe Mirdita, me një ulje 1-2%. Bashkitë me rritjen më të madhe të shpenzimeve në vitin 2023 krahasuar me vitin e mëparshëm janë Librazhdi dhe Përmeti (47% rritje), ndjekur nga Kamza (44%); Vau i Dejës (36%) dhe Saranda (32%). Bashkia Tiranë ka rritur gjithashtu shpenzimet me 29% ndaj shpenzime të saj të vjetshme, çka ka një ndikim të ndjeshëm në rritjen e shpenzimeve agregate të bashkive.

Ndryshimi i shpenzimeve në rritje në shumicën e njësive të vetëqeverisjes vendore, ku përfshihen kryesisht bashkitë që zënë një peshë të madhe në totalin e shpenzimeve të pushtetit vendor janë një tregues i rëndësishëm i ecurisë pozitive ekonomike që kanë patur njësitë e vetëqeverisjes vendore gjatë vitit buxhetor 2023. Konsolidimi i menaxhimit financiar publik në nivel vendor, duhet të reflektohet në të gjithë treguesit me qëllim ndikimin e drejtpërdrejtë në cilësinë e jetës së qytetarëve. Është e rëndësishme që rritja e shpenzimeve të shoqërohet me përmirësim të drejtpërdrejtë të cilësisë së shërbimeve publike, e të rritet vëmendja ndaj mundësisë së përmbajtjes së kostove të personelit.

Figura 23 Ndryshimi i shpenzimeve sipas bashkisë 2023/2022



Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave (2024)

Shpenzimet vendore sipas natyrës ekonomike


Shpenzimet për personelin janë kategoria kryesore e shpenzimeve të buxhetit vendor, me rreth 30 miliardë lekë të shpenzuara për paga e sigurime në vitin 2023, ose 42.9% e buxhetit vendor nga burimet e veta. Ky është një raport mjaft i lartë, i krahasueshëm me peshën e zërave të tjerë të shpenzimeve ato për investime dhe zëri të tjera.

Pesha e shpenzimeve kapitale në buxhetin vendor është rritur gjithashtu. Në vitin 2023, njësitë e vetëqeverisjes vendore kryen investime në masën 16.5 miliardë lekë, 4.6 miliardë lekë më shumë se një vit më parë; duke e rritur peshën e investimeve në 24% të shpenzimeve nga burime të pakushtëzuara, nga 20% në 2022. Investimet publike në nivel vendor kanë një impakt të drejtpërdrejtë në jetën e qytetarëve. Një ndër objektivat e reformës territoriale dhe decentralizimit fiskal është lidhur pikërisht me mundësinë e krijimit të kushteve për njësi të vetëqeverisjes vendore më të afta financiarisht e me ndikim në zhvillimin ekonomik vendor.

Së fundmi, një rritje e lehtë vërehet edhe në shpenzimet operative (19 miliardë lekë), të cilat zënë 28% të shpenzimeve vendore në krahasim me 32% një vit më parë; si edhe në transfertat e tjera korrente (3.2 miliardë lekë ose 5 % e shpenzimeve), të cilat përfshijnë kryesisht transfertat të brendshme korrente subvencione dhe transfertat në buxhetet familjare (kryesisht për mbështetje sociale).

Zmadhimi i hapësirës fiskale të buxhetit vendor gjatë vitit 2023, si rezultat i rritjes së të ardhurave të veta vendore dhe transfertave nga buxheti i shtetit, është dedikuar kryesisht për rritjen e investimeve (4.6 miliardë lekë më shumë shpenzime kapitale, ose 44% e shpenzimeve vjetore) dhe për shpenzime personeli (4.4 miliardë lekë më shumë, ose 42% shpenzimeve vejtore).


Figura 24 Shpenzimet 2023 sipas klasifikimit ekonomik (milionë lekë)



Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave (2024)

Ashtu si në rastin e të ardhurave të veta, struktura e shpenzimeve vendore dominohet nga bashkia Tiranë dhe bashkitë e tjera më të mëdha, ndonëse pesha relative e tyre nuk është njësoj dominante. Shpenzimet e bashkisë Tiranë përbëjnë 33% të shpenzimeve të përgjithshme vendore nga burimet e veta, së bashku me gjashtë bashkitë e tjera me shpenzimet faktitk më të madha (Durrës, Fier, Vlorë, Shkodër, Elbasan, Kamëz), ato zënë 55% të gjithë shpenzimeve vendore. Dhjetë bashkitë e mesme për nga popullsia (midis 50 dhe 100 mijë banorë: Lushnjë, Korçë, Lezhë, Berat, Pogradec, Krujë, Dibër, Kurbin, Kavajë, Kukës) kanë një peshë totale prej 16% të shpenzimeve të përgjithshme vendore, gjithë bashkit e tjera rreth 31% dhe qarqet vetëm 1.3%.

Figura 25 Pesha e bashkive në shpenzime sipas madhësisë dhe natyrës ekonomike



Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave (2024)

Bashkia Tiranë dhe gjashtë bashkitë më të mëdha shpenzojnë përkatësisht 32% dhe 44% të buxhetit të tyre të përgjithshëm nga burime e veta për kostot e personelit, ndërsa pesha e shpenzimeve kapitale është rreth 25% e buxhetit. Edhe në mes të gjashtë bashkive të mëdha ka luhatje të rëndësishme në peshat e buxhetit: pesha e kostove të personelit luhatet nga 32% në Kamëz, në mbi 50% në Vlorë, Fier e Elbasan. Po ashtu, pesha e investimeve në buxhetin e tyre luhatet nga 10% në 53% në bashkinë Kamëz.


Bashkitë e tjera shpenzojnë mesatarisht 51% të buxhetit për pagat e personelit; ndërsa pesha e investimeve në buxhetet e tyre është mesatarisht 17% për dhjetë bashkitë e mesme dhe 25% për 44 bashkitë më të vogla. Në të paktën 14 bashkië, përfshirë dy bashki të mesme, pesha e shpenzimeve të personelit është mbi 60% e shpenzimeve të përgjithshme nga burimet e pakushtëzuara.

Pesha e larte e kostove të personelit në strukturën e përgjithshme të shpenzimeve vendore ngre shqetësime për efektivitetin dhe eficiencën e ofrimit të shërbimeve. Megjithatë, të dhënat agregate për kosot e pagave dhe sigurimeve duhet të interpretohen me një vëzhgim më të ngushtë në secilën bashki. Në disa raste, kostot e pagave dhe sigurimeve lidhen direkt me njësitë e ofrimit të shërbimeve, atëherë kur shërbime thelbësore ofrohen direkt nga bashkia e nuk janë të jashtëkontraktuara.

Shpenzimet e NJVQV-ve sipas popullsisë


Gjatë vitit 2023, NJVQV kanë shpenzuar mesatarisht 20,858 lekë për banor, ose 3,400 lekë më shumë për banor se një vit më parë. Nga këto, mesatarisht gjysma e këtyre shpenzimeve për banor është financuar nga të ardhurat e veta të bashkive dhe gjysma tjetër kryesisht nga transferta e pakushtëzuar dhe sektoriale.

Figura 26 Shpenzimet mesatare për banor sipas burimit të financimit 2023



Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave (2024)

Figura 27 Shpenzimet mesatare për banor sipas natyrës ekonomike e madhësisë së bashkisë




Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave (2024)

Dallimet në strukturën e shpenzimeve vendore sipas madhësisë së popullsisë vërehen qartë edhe në analizën e shpenzimeve sipas natyrës ekonomike. Tirana ka mesatarisht shpenzimet më të larta për banor për të gjitha kategoritë e shpenzimeve.

Shpenzimet e personelit janë mesatarisht 9,871 lekë për banor për të gjitha bashkitë; në bashkitë e vogla shpenzimet e personelit për banor janë mesatarisht 10,631 lekë për banor, ose 8% më të larta se mesatarja kombëtare. Megjithatë, duhet theksuat se ndër bashkitë e vogla me popullsi nën 50 mijë banorë, ka të paktën 19 bashki ku shpenzimet e personelit për banor e tejkalojnë mesataren kombëtare me 15% - 84%, ndërkohë që të paktën gjysma kanë shpenzime më të ulëta se mesatarja kombëtare. Bashkitë e mesme dhe të mëdha, ku shpenzimet e personelit për frymë luhaten mes 6,000 lekë (Kurbini) dhe 9,928 lekë (Kukësi), kanë shpenzime mesatare për personelin më të ulëta se mesatarja kombëtare, ndërsa në Tiranë këto janë rreth 15% më të larta se mesatarja kombëtare.

Figura 28 Shpenzimet për banor sipas natyrës ekonomike dhe bashkive



Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave (2024)

Shpenzimet mesatare për investime për çdo banor janë më të lartat në bashkinë Tiranë (dyfishi i mesatares kombëtare) dhe mesatarisht më të ulëtat në dhjetë bashkitë e mesme. Investimet për banor janë lehtësisht më të larta se mesatarja kombëtare në bashkitë e vogla. Mesatarja e bashkive të vogla rritet për shkak të investimeve shumë të larta për banor në bashkinë Himarë gjatë vitit 2023 (23,436 lekë për banor); por mbetet më e lartë se mesatarja kombëtare dhe e bashkive më të mëdha edhe pa llogaritur Himarën.

Sipas njësive të vetëqeverisjes vendore, gjatë vitit 2023, bashkitë me vlerën më të vogël të shpenzimeve të investimeve për banor janë **bashkia Peqin me rreth 580 lekë për banor, bashkia Tepelenë (650 lekë për banor) dhe Libohovë (835 lekë për banor)**. Edhe bashki të mesme (si Kavaja, Kurbin) dhe të mëdha (si Vlora), kanë kryer shumë pak investime për banor gjatë periudhës në fjalë, mes 1,200 dhe 1,400 lekë për banor. Nga ana tjetër bashkitë me shpenzimet më të mëdha për investime në raport me banorët gjatë vitit 2023, **janë bashkia Himarë me rreth 23.4 mijë lekë, bashkia Kamëz (13.4 mijë lekë) dhe Përmet (11.7 mijë lekë)**.

Shpenzimet përkundrejt transfertave dhe të ardhurave të veta

Në raport me transfertën e pakushtëzuar të përgjithshme prej **rreth 21.7 miliardë lekë**, gjatë vitit 2023, shpenzimet kapitale në vlerën **e rreth 16.5 miliard lekë, zënë 76% të transfertës së pakushtëzuar** ndërsa ndaj transfertës së pakushtëzuar të përgjithshme dhe sektoriale zënë rreth 49%. Për një pjesë të konsiderueshme të njësive të vetëqeverisjes vendore, raporti i investimeve ndaj transfertave të përgjithshme dhe sektoriale është shumë i ulët.

Përkundrejt të ardhurave të veta, shpenzimet kapitale në vitin 2023 arritën në 47%.


Njësitë e vetëqeverisjes vendore duhet të rrisin financimin e investimeve përmes të ardhurave të veta, ky është është një ndër treguesit kyç të rëndësisë së qeverisjes vendore për zhvillimin ekonomik dhe i eficiencës së menaxhimit financiar.

Shpenzimet e personelit ndaj të ardhurave të veta gjatë vitit 2023 zënë rreth 84%, ndërsa ndaj transfertës së pakushtëzuar dhe sektoriale zënë rreth 89%.

Në të gjitha bashkitë përveç bashkisë Himarë, Kamëz dhe Librazhd shpenzimet për investime kanë qenë më të ulëta se shpenzimet për personelin. Megjithatë, vërehet se ky hendek është më i theksuar te bashkitë me të ardhura të veta më të ulëta.


Një pamje më e qartë e këtyre raporteve paraqitet në grafikët e mëposhtëm (figura 29 dhe 30).

Figura 29 Shpenzimet kapitale dhe për personelin përkundrejt të ardhurave të veta



Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave (2024)

Figura 30 Shpenzimet kapitale dhe për personelin përkundrejt transfertës së pakushtëzuar e sektoriale



Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave (2024)


Shpenzimet e personelit për numër punonjësish

Element i rëndësishëm i analizës janë shpenzimet e personelit në raport me numrin e punonjësve të njësive të vetëqeverisjes vendore. Një ndër objektivat e reformës administrative-territoriale ishte krijimi i kushteve për një administratë vendore efektive. Ministria e Financave përvec zërave të tjerë të shpenzimeve monitoron edhe ecurinë e shpenzimeve të personelit.

Referuar Sistemit Informatik Financiar të qeverisë, gjatë vitit 2023 numri i punonjësve në nivel vendor është 37 mijë punonjës.

Numri i punonjësve rritet me rritjen e madhësisë së bashkisë. Në vitin 2023, bashkia Tiranë, e cila ka 19% të popullsisë efektive, rezulton më të punësuar rreth 8,112 punonjës, ose ndryshe 22% të totali të administratës vendore. Gjashtë bashkitë e mëdha, me 28% të popullsisë efektive, punësojnë 7,984 punonjës, ose 21.5 e gjithë punonjësve të bashkive. Dhjetë bashkitë e mesme, me 21% të popullsisë, punësojnë 7,489 punonjës dhe së fundmi, bashkitë e vogla, për 31% të popullsisë punësojnë 13,5 mijë staf, ose 36.5% të gjithë punonjësve bashkiakë.

Figura 31 Numri i punonjësve gjithsej dhe për 1000 banorë sipas bashkive



Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave (2024)

Në përgjithësi, bashkitë me popullsi më të vogël kanë numër më të vogël punonjësish, por numër më të lartë punonjësish për 1000 banorë. Bashkia Tiranë ka 13 punonjës për 1000 banorë dhe bashkitë e mëdha kanë mesatarisht 9 punonjës për

1000 banorë; që luhatet nga 6 (Shkodra), në 10 (Kamza dhe Vlora). Bashkitë e mesme kanë mesatarisht 10 punonjës për 1000 banorë, që luhatet nga 8 (Kruja) në 14 (Kukësi). Së fundmi, numri i punonjësve për 1000 banorë për bashkitë e vogla luhatet nga 7 (Rrogozhinë) në 28 (Fushë Arrëz), me një mesatare prej 15 punonjës për 1000 banorë.

Krahasuar me një vit më parë, numri i punonjësve në bashki është rritur me rreth 430 persona. Bashkia me rritjen më të madhe të numri të punonjësve krahasuar me vitin 2023, janë bashkitë Vlorë dhe Kamzë me përkatësisht 210 dhe 201 punonjës më shumë, ndjekur nga bashkia Tiranë me 174 punonjës më shumë. Disa bashki kanë rënie të numrit të punonjësve në vitin 2023 krahasuar me një vit më parë, si Shkodra me një rënie të ndjeshme prej 368 punonjësish (-27%) dhe Memaliaj me 119 punonjës më pak (-37%).

Shpenzimet mesatare për punonjës luhaten në një gamë të ngushtë, me një mesatare prej 62.5 mijë lekë në muaj për punonjës. Nivelet e pagave të administratës vendore janë të përcaktuara në kuadrin ligjor. Gjatë vitit 2023 nga Ministria e Financave është financuar efekti financiar për rritjen e kufirit minimal sipa kategorive të VKM-së nr 328. datë 31.05.2023 "Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e NJVQV-ve për efekt page, dhe caktimin e kufijëve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të NJVQV-ve", si dhe mbulimi i efektit të rritjes së pagës minimale nga 34 mijë lekë në 40 mijë lekë.


Në total, **shpenzimet e personelit të bashkive prej 29.4 miliardë lekë** në raport me **21.7 miliardë lekë** që buxheti qendror jep në formën e transfertës së pakushtëzuar të përgjithshme, janë rreth **135%**.

Si në nivel kombëtar ashtu edhe në nivel njësie vendore, gjatë vitit 2023 bashkitë kanë patur një rritje të shpenzimeve të personelit, tregues ky i cili është reflektuar edhe në raport me transfertën e pakushtëzuar. Një pjesë e bashkive si: Tiranë, Vorë, Roskovec, Kavajë e Himarë e Sarandë, kanë një nivel mjaft të lartë të këtij raporti në krahasim me pjesën tjetër të bashkive. Megjithatë, këto bashki kanë njëkohësisht një nivel relativisht të lartë të të ardhurave të veta në krahasim me transfertat e pakushtëzuara. Ndërkohë, konstatohet një trend i qëndrueshëm i një raporti të përafërt në të gjitha bashkitë ndërmjet shpenzimeve të personelit dhe transfertës së pakushtëzuar.

Shpenzimet vendore sipas natyrës funksionale

Struktura e shpenzimeve diktohet nga funksionet e njësive të qeverisjes vendore dhe burimeve të financimit përkatëse. Sektori me peshën më të lartë në shpenzimet vendore nga burime të pakushtëzuara në vitin 2023 janë **çështjet ekonomike, ku përfshihen mes të tjerash bujqësia, administrimi i pyjeve, ujitja dhe kullimi, turizmi dhe transporti, me 14.5 miliardë lekë ose 21 përqind të shpenzimeve të përgjithshme**, ndjekur nga sektori i shërbimeve **të përgjithshme publike (14 miliardë lekë, ose 20 përqind) dhe arsimit (12.8 miliardë, ose 18.6 përqind)**. **Pesha e këtyre shpenzimeve të pushtetit vendor sipas funksioneve paraqet qartë rëndësinë që kanë këto shpenzime në raport me shërbimet publike që njësitë e vetëqeverisjes vendore ushtrojnë.**

Figura 32 Pesha e shpenzimeve sipas natyrës funksionale 2023 dhe 2022




Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave (2024)

Shpërndarja e shpenzimeve të pushtetit vendor ka ruajtur të njëjtën strukturë si në vitet pararendëse, me një ulje të lehtë të peshës së shërbimeve të përgjithshme publike (20% në 2023 nga 22% në 2022) dhe rritje të peshës së shpenzimeve për funksionin e çështjeve ekonomike (21% nga 18%). Pësja e sektorit “strehimi dhe komoditetet e komuniteteit”, ku ndër të tjera përfshihen shpenzime të lidhura me ujësjellës, kanalizimet, planifikimi urban apo ndriçimi, ka rënë ndjeshëm, nga 18% në 16% të shpenzimeve në vitin 2023, pavarësisht një rritjeje të lehtë në vlerë nominale prej 275 milionë lekësh. Shpenzimet në sektorët e tjerë kanë pasur një rritje të lehtë në vlerë nominale, ndonëse pësja e tyre relative në buxhetin vendor ka rënë në vitin 2023. Nga grafiku më sipër duket sikur mbrojtja sociale ka një përqindje të ulët krahasuar me funksionet e tjera, kjo sepse më së shumti ky funksion financohet nga buxheti qendror në formën e transfertës së kushtëzuar dhe në analizë është përfshirë vetëm financimi i bashkive nga burimet e veta për këtë funksion.

Gjatë vitit 2023, të gjitha bashkitë, peshën më të madhe të shpenzimeve e kanë përdorur për financimin e 3 funksioneve siç është ai për “Shërbimet e përgjithshme publike” “Arsimin”, dhe “Çështjet ekonomike”. Ruajtja e një trendi të ngjashëm të peshës së funksioneve si në bashkitë e mëdha ashtu edhe në ato më të vogla, tregon rëndësinë që këto funksione kanë për shërbimet në nivel vendor.

Figura 33 Peshë e shpenzimeve sipas naturës së funksioneve të pushtetit vendor sipas bashkive, 2023




Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave (2024)

Shpenzimet vendore sipas burimit të financimit

Analiza e shpenzimeve të pushtetit vendor sipas burimeve është një aspekt i rëndësishëm që evidenton nivelin e varësisë ndaj transfertave të buxhetit qendror dhe pavarësinë e financimit përmes të ardhurave të veta vendore. Roli i transfertës së pakushtëzuar në financimin e veprimtarisë së pushtetit vendor është një tregues i rëndësishëm dhe si të tillë në kapitujt e mëposhtëm do ta analizojmë në mënyrë të detajuar. Ashtu siç mund të shihet në grafikun e mëposhtëm, shpenzimet e pushtetit vendor sipas burimit të financimit gjatë vitit 2023 janë mbuluar pothuajse në mënyrë të barabartë ndërmjet transfertës së pakushtëzuar dhe të ardhurave të veta vendore, ndonëse shpenzimet nga të ardhurat e veta kanë tejkaluar nivelin e shpenzimeve nga transfertat, në linjë me trendin në rritje të të ardhurave të veta. Ky trend i burimit të financimit ka ndryshuar lehtësisht në krahasim me vitin 2022, kur shpenzimet nga të ardhurat e veta përbënin 48% të shpenzimeve të përgjithshme vendore.

Figura 34 Struktura e shpenzimeve vendore sipas burimit të financimit 2023




Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave (2024)

Në kuadër të thellimit të politikave të decentralizimit fiskal të pushtetit vendor, njësitë e vetëqeverisjes vendore përmes rritjes së kapacitetit fiskal të tyre duhet të vijojnë të synojnë drejt rritjes së peshës së të ardhurave të veta në këtë raport. Reflektimi i këtij raporti do të jetë një pikënisje e rëndësishme për të konsideruar se tashmë politikat në nivel vendor po japin efekt thelbësor.

Analiza e treguesve jo vetëm në nivel kombëtar por edhe sipas njësive të vetëqeverisjes vendore për burimin e financimit të shpenzimeve në vitin 2023, paraqitet si në grafikun e mëposhtëm. Në këtë rast është qartësisht e evidentueshme varësia e bashkive të vogla nga transfertat e buxhetit qendror dhe bashkive të mëdha nga të ardhurat e veta vendore, kjo reflekton faktin që autonomia fiskale nuk është shtrirë në formë simetrike në të gjithë pushtetin vendor.

Figura 35 Struktura e shpenzimeve sipas bashkive dhe burimeve të financimit



Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave (2024)

Detyrimet e prapambetura


Detyrimet e prapambetura vazhdojnë të jenë problem edhe për vitin 2023. Gjatë vitit 2023, janë realizuar vlerësime dhe raportime periodike mbi ecurinë financiare të detyrimeve të prapambetura të njësisë të vetëqeverisjes vendore. Gjatë vitit 2023, Ministria e Financave në mënyrë të vazhdueshme ka ndjekur dhe monitoruar procesin e menaxhimit financiar në nivel vendor dhe përmes tij vlerësimin e treguesve të performacës së NJVQV. Në vitin 2023 Ministria e Financave ka përgatitur dhe publikuar raportin e gjendjes financiare për të 61 bashkitë për vitin 2022, ku ka rezultuar se 49 bashki dhe 9 qarqe janë pa probleme financiare, 8 bashki dhe 1 qark kanë probleme financiare dhe 4 bashki 2 qarqe janë me vështirësi financiare. Për këto të fundit, është hartuar një plan rehabilitimi për daljen nga situata e problemeve/vështirësisë financiare i cili do të vijojë të zbatohet edhe gjatë vitit 2024. Në këtë drejtim, janë përgatitur raporte periodike në funksion të transparencës, përgjegjshmërisë dhe pjesëmarrjes së të gjitha grupeve të interesit në procesin e administrimit financiar vendor. Gjithashtu, është monitoruar periodikisht edhe plani i shlyerjes së detyrimeve për bashkitë me vështirësi financiare për daljen nga kjo situatë.

Stoku i detyrimeve të prapambetura **në fund të muajit dhjetor 2023**, i cili parashikohet të shlyhet në një periudhë afatmesme, bazuar në planin e shlyerjes së dërguar nga të gjitha bashkitë në Ministrinë e Financave është rreth **4.8 miliard lekë**. Vlera e stokut të detyrimeve të prapambetura është ulur me rreth 3 miliard lekë, krahasuar me stokun e detyrimit në fund të tremujorit të tretë të vitit 2023, dhe **është ulur me rreth 0.59 miliard lekë, krahasuar me stokun e detyrimit në fund të vitit 2022**, që ishte 5.4 miliard lekë.

Stokun më të lartë të detyrimeve e ka bashkia Kavajë në vlerën rreth 794 milion lekë, e cila përbën 16.7% të totalit të detyrimeve. Më pas, bashkia Tiranë në vlerën rreth 788 milion lekë, e cila përbën 16.6% të totalit të detyrimeve; bashkia Vorë në vlerën rreth 363 milion lekë, e cila përbën 7.6% të totalit të detyrimeve; bashkia Durrës në vlerën rreth 311.5 milion lekë, e cila përbën 6.6% të totalit të detyrimeve; bashkia Pogradec në vlerën rreth 224 milion lekë, e cila përbën 4.7% të totalit të detyrimeve. Më pas renditen bashkia Dibër dhe Lezhë.

Sa u përket qarqeve, stokun më të lartë të detyrimit vazhdon e ka qarku Durrës në vlerën rreth 40.3 milion lekë, më një ulje prej 20% nga viti 2022; qarku Berat në vlerën rreth 39.1 milion lekë, ose vetëm 0.5 milionë lekë më pak se një vit më parë, qarku Gjirokastër në vlerën 5.6 milionë lekë, osë thuhet 50% më pak se një vit më parë. Qarku Vlorë dhe Korçë kanë detyrime të prapambetura minimale (përkatesisht 1.3 dhe 0.3 milionë lekë).

Figura 36 Detyrimet e prapambetura të pushtetit vendor në vite




Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave (2024)

Sipas kategorive, peshën më të madhe të stokut të detyrimeve e zë kategoria “Investime” me 47%, ndjekur nga “Të tjera” 25%, “Shërbime” 11%, dhe “Vendime Gjyqësore” 9%. Në vitin 2023 është rritur pesha e stokut e lidhur me investimet e pashlyera, si dhe aktivitete të tjera, që janë të lidhura drejtpërdrejt me disiplinën fiskale në nivel vendor.

Ndërsa sa u përket qarqeve, stoku i detyrimit të tyre përbëhet kryesisht nga vendime gjyqësore, të cilat zënë 95.9% të totalit të detyrimit të qarqeve.

Figura 37 Pesha e detyrimeve të prapambetura të pushtetit vendor sipas natyrës



Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave (2024)

Ulja e nivelit të detyrimeve të prapambetura të pushtetit vendor është një objektiv i rëndësishëm për të siguruar qëndrueshmërinë financiare të njësive të vetëqeverisjes vendore. Në këtë drejtim, pushteti vendor ka përmirësuar ndjeshëm performancën financiare duke ulur në këtë mënyrë detyrimet e prapambetura në të gjitha kategoritë.

Në analizën e detyrimeve të prapambetura konstatohet se një ndër faktorët e krijimit të tyre janë parashikimet optimiste të të ardhurave të veta vendore të realizuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, të cilat përkthehen në angazhime buxhetore mbi kapacitetin normal të njësive të vetëqeverisjes vendore.

Detyrimet e prapambetura ndaj totalit të ardhurave të veta vendore;


Stoku i **detyrimeve të prapambetura gjatë vitit 2023, përbën rreth 13.8% të të ardhurave të veta totale të njësive të vetëqeverisjes vendore.** Krahasuar me një vit më parë, si rrjedhojë e rritjes së të ardhurave të veta ky raport është zvogëluar **me rreth 3.6% për shkak të uljes së detyrimeve dhe rritjes së të ardhurave të veta.**

Megjithatë, midis bashkive, mesatarja e raportit të detyrimeve të prapambetura ndaj të ardhurave të veta është më e lartë, rreth 53%, ndonëse gjysma e bashkive kanë stok më të ulët se 30% të detyrimeve të prapambetura ndaj **të ardhurave të veta. Një pjesë e bashkive kanë një raport mjaft të lartë, mbi 100% të stokut të detyrimeve të vitit 2023 ndaj të ardhurave të veta, si Klosi (339%), Memaliaj (270%), Dibra (156%), Malësia e Madhe (139%); Puka, Peqini, Dimali, Cërriku (120%); Kavaja dhe Tropoja (110%).** Kapaciteti fiskal mjaft i ulët i shumicës së këtyre bashkive dhe menaxhimi jo i mirë i mbledhjes së të ardhurave dhe planifikimit të shpenzimeve ka krijuar këto problematika në stokun e detyrimeve.

Nga ana tjetër, pjesa më e madhe e NJVQV-ve si: Korçë, Shkodër, Shijak, Sarandë, Himarë, etj, kanë një raport të ulët të stokut të detyrimeve në vitin 2023 mbi të ardhurat e veta. Kapaciteti fiskal i qëndrueshëm është një arsye edhe më e fortë për të siguruar cilësi të lartë të menaxhimit financiar dhe disiplinë fiskale, duke mos lejuar krijimin e detyrimeve të prapambetura.

Për sa më sipër, njësitë e vetëqeverisjes vendore që kanë një raport pranë apo mbi 100% të stokut të detyrimeve ndaj të ardhurave të veta faktike, duhet të marrin masa të menjëhershme jo vetëm në drejtim të shlyerjes së detyrimeve por gjithashtu të rritjes së kapacitetit fiskal.

Figura 38 Detyrimet e prapambetura ndaj të ardhurave të veta, 2023




Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave (2024)

Detyrimet e prapambetura ndaj shpenzimeve vjetore faktike

Për të evidentuar më qartë problematikën e krijimit të detyrimeve të prapambetura, ato janë vendosur në raport me faktin e shpenzimeve vjetore të realizuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore. Gjatë vitit 2023 në nivel kombëtar, stoku i **detyrimeve të prapambetura prej 4.8 miliardë lekë zë rreth 7% të totalit të shpenzimeve faktike të njësive të vetëqeverisjes vendore.** Si në grafikun e mëposhtëm, ky raport gjatë vitit 2023 paraqitet për të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Figura 39 Detyrimet e prapambetura ndaj shpenzimeve vjetore sipas bashkive 2023



Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave (2024)

Në bashkitë Vorë dhe Kavajë stoku i detyrimeve të pashlyera është relativisht i lartë dhe kalon raportin mbi 50% të detyrimeve të prapambetura ndaj shpenzimeve faktike. Ky raport është gjithashtu i lartë për qarqet, ndonëse kanë detyrime të pashlyera relativisht të ulëta në vlerë nominale. Pjesa tjetër e njësive të vetëqeverisjes vendore kanë një raport relativisht të ulët të stokut të detyrimeve të prapambetura ndaj shpenzimeve vjetore.

Kapaciteti i ulët fiskal dhe parashikimi jo realist i planit të të ardhurave dhe shpenzimeve nga njësitë e vetëqeverisjes vendore gjatë vitit 2023 janë arsye kryesore të rritjes së stokut të detyrimeve të prapambetura të njësive të vetëqeverisjes vendore. Krijimi i një plani realist të të ardhurave të veta vendore duke shmangur në këtë mënyrë marrjen e agazhimeve buxhetore mbi të cilin ka kapacitet fiskal bashkia, është masa imediate e cila do të shmangë rritjen e stokut aktual të detyrimeve të prapambetura dhe uljen e tij në të ardhmen.



Decentralizimi dhe treguesit fiskalë vendore krahasuar me vendet e rajonit dhe OECD



Një aspekt i rëndësishëm i analizës së financave vendore është krahasimi me vendet e tjera të rajonit apo OECD, për të evidentuar treguesit pozitivë apo trendet negative në rastin e Shqipërisë. Pavarësisht përmirësimeve të dukshme ndër vite të treguesve të pushtetit vendor, në objektivat afatgjatë të Ministrisë së Financave është përafrimi me treguesit fiskalë të pushtetit vendor në vendet e rajonit apo OECD-së.

Krahasimi i treguesve ndërmjet vendeve sigurisht që është një proces kompleks, jo vetëm se niveli i decentralizimit administrativ dhe fiskal është shumë i ndryshëm në vende të ndryshme, por edhe pse vende të ndryshme kanë tipare të veçanta të cilat duhen analizuar sipas rastit. Në këtë drejtim, për të arritur rezultate sa më të sakta në këtë seksion u jemi referuar treguesve të ngjashëm të pushtetit vendor ndërmjet Shqipërisë dhe vendeve të tjera. Disa nga risqet kryesore të analizës krahasimore ndërmjet vendeve janë:

Niveli i rritjes ekonomike, e cila shprehet përmes diferencës së Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB), në Shqipëri është i ndryshëm në krahasim me vendet e tjera të OECD-së apo rajonit, duke treguar performancë ekonomike të ndryshme. Nga ana tjetër, **niveli i inflacionit** ka një ndikim në fuqinë blerëse të konsumatorëve dhe në stabilitetin ekonomik të vendeve të caktuara.

Një tjetër risk i rëndësishëm krahasimor është **niveli i taksave dhe tatimeve** në Shqipëri apo vende të tjera, kjo mund të ndikojë në konkurrueshmërinë fiskale të vendit dhe në të ardhurat e qeverisë. Vende të ndryshme përdorin regjim të ndryshëm fiskal që i përputhet katakteristikave sociale, kulturore apo natyrore.

Së fundmi, njësitë e qeverisjes vendore kanë funksione dhe kompetenca të ndryshme nga vendi në vend. Niveli i decentralizimit fiskal duhet analizuar në mënyrë proporcionale me kompetencat vendore.

Por si qëndron Shqipëria në nivelin e autonomisë krahasuar me vendet e tjera? Sigurisht është e qartë se sa më e lartë të jetë përqindja e transfertave ndërqeveritare, aq më e madhe është varësia financiare e pushtetit vendor nga nivelet e tjera të qeverisjes dhe aq më e ulët është autonomia vendore.

Mesatarja e këtij raporti në vendet e **OECD ishte 49.5% në vitin 2022, tregues ky i një varësie të fortë të pushtetit vendor nga transfertat ndërqeveritare**². Në 13 nga 27 vende të OECD-së, transfertat ndërqeveritare përfaqësojnë pjesën më të madhe të buxhetit vendor, duke zënë 50% ose më shumë të të ardhurave vendore. Lituania, Estonia, Republika Sllovaqe dhe Holanda janë vendet me përqindjen më të lartë të transfertave ndërqeveritare, përkatësisht me një peshë prej 88.6%, 85%, 76% dhe 74.7%.

Ndër 14 vendet e tjera, Islanda dhe Zvicra kanë peshën më të ulët: transfertat ndërqeveritare përbëjnë vetëm 9.5% (Islanda) dhe 10.9% (Zvicër) të të ardhurave të përgjithshme vendore.

Krahasuar me këto vende Shqipëria ruan trende të ngjashme me një përqindje prej rreth 48.7% të transfertave ndërqeveritare (transfertë e pakushtëzuar dhe sektoriale dhe taksa të ndara). Forcimi i kapacitetit fiskal të pushtetit vendor në Shqipëri është një aspekt i rëndësishëm i uljes së këtij raporti në vite. Thellimi i decentralizimit fiskal


2. OECD Fiscal federalism database, January 2024, në <https://ëëë.oecd.org/tax/federalism/fiscal-decentralisation-database/>

në përputhje me objektivat e strategjisë do të jetë një hap i rëndësishëm për të konsoliduar këtë raport krahasuar me vendet e tjera të Europës.

- Treguesit e transfertave ndërqeveritare

Pushteti vendor është një kontributor i rëndësishëm i rëndësishëm në Produktin e Brendshëm Bruto të një vendi. Niveli i kontributit është i ndryshëm në vende të ndryshme, dhe si rrjedhim vlerësimi i nivelit të transfertës ndërqeveritare që përfiton pushteti vendor në raport me PBB-në është një moment i rëndësishëm krahasimi. Si në grafikun e mëposhtëm vendet e OECD-së mesatarisht shpërndajnë në formën e transfertës ndërqeveritare rreth 5.53% të Produktit të Brendshëm Bruto për pushtetin vendor. Ndërkohë Shqipëria është pothuajse në limitin e përcaktimit ligjor në vetëm 1% të PBB-së për transfertën e pakushtëzuar dhe 1.5% të PBB-së duke përfshirë transfertat sektoriale.

Figura 40 Transfertat ndërqeveritare ndaj PBB-së (2013 – 2022)



Burimi: OECD Fiscal Decentralization database (2024); për Shqipërinë, Ministria e Financave


Ashtu siç mund të konstatohet në grafikun e mësipërm, vende të BE-së me një decentralizim funksional dhe fiskal mjaft të thelluar të tilla si Austria, Italia apo Sllovakia kanë një përqindje të lartë të Produktit të Brendshëm Bruto që shkon si transfertë ndërqeveritare, përkatësisht 11.5%, 8.3% apo 6%. Të gjitha vendet e shqyrtuara kanë ruajtur nivele të qëndrueshme të transfertave ndërqeveritare, me tendencë në rritje, me përjashtimin e Hungarisë.

Në këtë kontekst, Shqipëria mbetet në vendet me nivelin më të ulët të transfertave ndërqeveritare në raport me Produktin e Brendshëm Bruto krahasuar jo vetëm me vendet e OECD, por edhe rajonit.

Angazhimi i qeverisë për të ndarë me pushtetin vendor një pjesë të shpenzimeve publike në formën e transfertave ndërqeveritare, është një aspekt i cili tregon vëmendjen që kanë siguruar shërbimet publike në nivel vendor. Mesatarisht për vitin 2022 vendet e OECD kanë një raport të transfertave ndërqeveritare ndaj shpenzimeve publike në rreth 9.6%, ose rreth tre herë më shumë se Shqipëria, ku transfertat e pakushtëzuar në vitin 2022 dhe 2023 ishin 2.9 dhe 3.4 përqindje shpenzimeve publike, ndërsa transfertat ndërqeveritare (e pakushtëzuar dhe sektoriale) arrijnë 5% të shpenzimeve publike në

Shqipëri; ndërsa transfertat e pakushtëzuar arritën përkatësisht 4.3 dhe 5 përqind, me një rritje të ndjeshme të pëeshës jo vetëm për shkak të rritjes së transfertave, por edhe për shkak të rënies së shpenzimeve të përgjithshme publike në vitin 2023 ndaj viti paraardhës. Megjithatë, pesha e transfertave për pushtetin vendor ndaj shpenzimeve të përgjithshme publike është e krahasueshme me nivelet e Shqipërisë në disa raste, si Greqia apo Franca. Në të dyja këto vende, transfertat zënë mbi 2.4 përqind të PBB-së, ndërsa raporti i tarnsfertave ndaj shpenzimeve publike është i ngjashëm me Shqipërinë pasi sektori publik në këto vende është krahasimisht më i gjerë se në Shqipëri. Në vitin 2023, transfertat ndërqeveritare (e pakushtëzuar dhe sektoriale) arritën 5% të shpenzimeve publike në Shqipëri; ndërsa transfertat e pakushtëzuar arriti 3.5%.

Figura 41 Transfertat ndërqeveritare ndaj shpenzimeve publike (2013 – 2022)




Burimi: OECD Fiscal Decentralization database (2024); për Shqipërinë Ministria e Financave

Në vende me një nivel të lartë të decentralizimit të shërbimeve publike si Austria, Estonia, Italia etj, gjatë vitit 2022 kanë një peshë të këtij raporti përkatësisht 18%, 17% dhe 12%. Ashtu si qartësisht evidentohen në grafikun e mësipërm, vende si Çekia apo Slovenia kanë pësuar një rritje të ndjeshme të këtij raporti përgjatë viteve, ashtu si edhe Shqipëria, kryesisht pas reformës administrativo-territoriale dhe miratimit të kuadrit ligjor për menaxhimin financiar në nivel vendor.

- Treguesit e shpenzimeve vendore

Shpenzimet e pushtetit vendor, në varësi të nivelit të decentralizimit por gjithashtu edhe të rolit që pushteti vendor ka në shërbimet publike kanë raport të ndryshëm të shpenzimeve vendore ndaj Produktit të Brendshëm Bruto. Mesatarisht vendet e OECD-së kanë një raport të shpenzimeve vendore ndaj Produktit të Brendshëm Bruto që është rreth 18.4%. Evidentohet që në varësi të nivelit zhvillimor të vendit edhe ky raport është i ndryshëm. Vende si Danimarka, Austria apo Çekia kanë një raport mjaft të lartë të shpenzimeve vendore ndaj PBB-së përkatësisht 29%, 8% dhe 12.6%.

Figura 42 Shpenzimet vendore ndaj PBB-së (2013 – 2022)




Burimi: OECD Fiscal Decentralization database (2024); për Shqipërinë Ministria e Financave

Shqipëria ka një raport mjaft të ulët të shpenzimeve vendore ndaj PBB-së në rreth 3% në vitin 2023. Të gjitha vendet e BE-së, përfshirë këtu edhe Shqipërinë, nga viti 2013 e në vazhdim kanë patur një trend të lehtë rritës të peshës së shpenzimeve vendore ndaj PBB-së, me përjashtim të Hungarisë. Megjithatë, edhe në Shqipëri vërehet një trend rritës i peshës së shpenzimeve vendore ndaj PBB-së. Kontributi i pushtetit vendor në prodhimin e brendshëm bruto të vendit është thelbësor për të konsoliduar rëndësinë që kanë shpenzimet vendore për cilësinë e shërbimeve publike.

Pushteti vendor është pjesë integrale e qeverisjes së përgjithshme, si rrjedhim pesha e shpenzimeve vendore ndaj atyre të qeverisjes së përgjithshme është tregues për rritjen e rolit të pushtetit vendor në shërbimet publike. Gjatë vitit 2022, mesatarisht vendet e OECD-së kanë një raport të shpenzimeve vendore ndaj shpenzimeve publike në rreth 21.7%. Vende europiane me decentralizim të thellë të tilla si Danimarka, kanë shpenzime vendore më shumë se sa ato qendrore, duke bërë që ky raport për vitin 2022 të jetë rreth 64.3%.

Figura 43 Shpenzimet vendore ndaj shpenzimeve të përgjithshme publike 2013 - 2022




Burimi: OECD Fiscal Decentralization database (2024); për Shqipërinë Ministria e Financave

Nga viti 2013 e në vazhdim Shqipëria ka ruajtur një trend të lehtë rritës të këtij raporti të shpenzimeve vendore ndaj totalit të shpenzimeve publike. Në vitin 2022 ky tregues është rreth 9%, një vlerë mjaft më e ulët se shumë vendet të tjera evropiane, por është rritur në vitin 2023 në 10.2 përqind. Gjatë vitit 2022, vendet e europës si Çekia, Austria dhe Sllovenia kanë një raport mjaft të lartë përkatësisht 28.3%, 14.9% dhe 19.1%. Gjatë viteve të fundit, veçanërisht në periudhën e krizës së pandemisë e më tej pothuajse të gjitha vendet e BE-së kanë patur një rënie të këtij raporti dhe ndryshe nga këto Shqipëria ka ardhur në rritje. Konsolidimi i menaxhimit të shpenzimeve vendore dhe rritja e cilësisë apo numrit të shërbimeve publike që ofrohen nga pushtetit vendor do të jenë momente të rëndësishme për decentralizimin në Shqipëri.

- Treguesit e të ardhurave vendore

Të ardhurat e veta janë një tregues i rëndësishëm i nivelit të autonomisë fiskale që pushteti vendor ka në vende të ndryshme. Gjatë vitit 2022 vendet e OECD-së kanë mesatarisht një raport rreth 5.2 përqind të të ardhurave të veta vendore ndaj PBB-së, në ulje të lehtë nga viti 2021 (5.3 përqind). Raporti i të ardhurave të veta vendore ndaj të ardhurave të përgjithshme publike është mesatarisht 11.7 përqind në vendet e OECD-së, gjithatë në rënie të lehtë nga viti 2021 (12.1 përqind). Raportin më të madh të të ardhurave të veta ndaj PBB-së e kanë vende si Danimarka, Çekia, Sllovenia me përkatësisht 13%, 8.4% dhe 5%.

Figura 44 Të ardhurat e veta vendore ndaj PBB-së (2013 – 2022)




Burimi: OECD Fiscal Decentralization database (2024); për Shqipërinë Ministria e Financave

Shqipëria ka një nivel mjaft të ulët të të ardhurave të veta në raport me Produktin e Brendshëm Bruto. Gjatë vitit 2022 dhe 2023, pushteti vendor në Shqipëri siguron të ardhura nga burimet e veta në rreth 1.5% të PBB-së (pa përfshirë të ardhurat jotatimore). Ajo që vihet re në grafikun e mësipërm, është një trend rënës në vite i këtij treguesi në të gjitha vendet e BE-së, ndërkohë Shqipëria ka ruajtur një trend rritës në vite.

Rritja e autonomisë vendore është ngushtësisht e lidhur me ecurinë e raportit të të ardhurave të veta vendore ndaj PBB-së. Thellimi i decentralizimit fiskal në vitet e ardhshme, ka rritur pritshmëritë e forcimit të rolit të pushtetit vendor në mbledhjen e të ardhurave nga burimet e veta.

Madhësia e pushtetit vendor në kapacitet fiskal matet përmes raportit të të ardhurave të veta vendore me të ardhurat publike të qeverisë së përgjithshme. Mesatarisht gjatë vitit 2022, vendet e OECD-se kanë një raport prej 11.7% të të ardhurave nga burimet e veta vendore me të ardhurat totale publike të qeverisjes së përgjithshme, në rënie nga viti i mëparshëm (12.1 përqind). Vende me një ecuri pozitive në drejtim të konsolidimit të autonomisë vendore, kanë një raport të lartë të tilla si Danimarka, Çekia, Sllovenia përkatësisht 27%, 20.2% dhe 11.3%, gjithastu në rritje nga viti 2021.

Figura 45 Të ardhurat e veta vendore ndaj të ardhurave të përgjithshme publike (2013 – 2022)



Burimi: OECD Fiscal Decentralization database (2024); për Shqipërinë Ministria e Financave

Raporti i të ardhurave të veta vendore ndaj të ardhurave të përgjithshme publike është më i lartë në Shqipëri krahasuar me disa nga vendet europiane të OECD-së. Gjatë vitit 2022 dhe 2023, Shqipëria ka realizuar të ardhura të veta vendore rreth 5% të të ardhurave publike, tregues ky më i madh se shtete europiane si Sllovakia, Greqia apo Estonia të cilat kanë një raport përkatësisht 4.5%, 2.6% dhe 3.6%.

Në këtë drejtim pushteti vendor në Shqipëri ka reflektuar një rritje më të shpejtë të të ardhurave nga burimet e veta vendore, krahasuar me të ardhurat e buxhetit qendror. Në këtë drejtim përmirësimi i kapacitetit fiskal të pushtetit vendor është një premisë mjaft pozitive për decentralizim fiskal të burimeve të tjera të të ardhurave nga qeveria qendrore.



Përfundime



Treguesit pozitivë të financave vendore gjatë vitit 2023 dëshmojnë për konsolidimin gradual të reformës dhe rritjes së cilësisë së menaxhimit financiar nëpërmjet zbatimit me sukses nga të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore të procedurave të hartimit të PBA-së, zbatimit të buxhetit dhe standardeve të monitorimit të realizimit të buxhetit vendor. Fokusi kryesor në buxhetin e vitit 2023 për Ministrinë e Financave ka qënë vazhdimi i konsolidimit të procesit të menaxhimit financiar në nivel vendor në funksion të vazhimit të zbatimit të procesit të decentralizimit fiskal të njësive të vetëqeverisjes vendore. Ministria e Financave ka vijuar me reformimin e financave publike vendore, duke u fokusuar në rritjen e investimeve, digjitalizimin e operacioneve të menaxhimit financiar në nivel vendor, dhe nxitjen e rritjes së të ardhurave nga taksat vendore. Gjatë 2023, janë ruajtur ngushtësisht treguesit pozitiv të rritjes së rolit të pushtetit vendor në forcimin e kapacitetit fiskal por gjithashtu edhe në rëndësinë e shërbimeve publike. Kjo është reflektuar në sigurimin për pushtetin vendor të një pakete më të gjerë të mbështetjes financiare për mbulimin e funksioneve të transferuara në nivel vendor, që u reflektua edhe në realizimin e treguesve fiskalë të financave vendore gjatë vitit 2023.

Konsolidimi i buxhetit vendor në 3% të PBB apo mbi 10% të buxhetit të shtetit, tregon qartazi potencialin në rritje të pushtetit vendor për ofrimin e shërbimeve. Një ndër treguesit më të rëndësishëm të konsolidimit fiskal të njësive të vetëqeverisjes vendore është rritja e aftësive të tyre për të siguruar të ardhura nga burimet e veta dhe arkëtimin e tyre në mënyrë të qëndrueshme në kohë. Gjatë 2023, u sigurua një rritje e rëndësishme e të ardhurave në raport me planin, tregues ky i kapacitetit në rritje të njësive për të siguruar qëndrueshmërinë e financimit të funksioneve. Treguesit kryesorë fiskalë dhe të autonomisë vendore për vitin 2023, paraqiten si më poshtë:

- Në vitin 2023, pushteti vendor ka përfituar në formën e **transfertës së pakushtëzuar së përgjithshme dhe sektoriale rreth 33.87 miliardë lekë, ose rreth 15.8% më shumë se një vit më parë.**
- Të ardhurat e veta vendore (taksat, tarifatat dhe të ardhurat jotatimore vendore) janë rreth 4.9% e të ardhurave publike, me një peshë rreth 0.1% më të lartë se në vitin 2022. Gjithashtu, pushteti vendor ka rritur rolin e tij në vite përmes kontributit në ekonomi duke ndryshuar raportin e të ardhurave të veta vendore nga 0.82% e PBB në vitin 2015, në 1.37 % në vitin 2023. Megjithë rritjen e PBB prej rreth 8.1% në raport më të lartë se një vit më parë, të ardhurat e pushtetit vendor për 2023 zënë 1.37% të PBB nga 1.29% që ishin në vitin 2022, duke reflektuar kështu edhe rritjen e rolit të pushtetit vendor në drejtim të shërbimeve publike dhe funksioneve që ushtron.
- Shpenzimet e pushtetit vendor janë rritur ndjeshëm edhe në vlerë nominale në vitin 2023, duke arritur **68.8 miliardë lekë**, ose rreth **17 % më shumë** se një vit më parë. Të ardhurat e veta vendore të realizuara gjatë vitit 2023 arritën 34.95 miliardë lekë ose rreth 51% të burimeve të përgjithshme vendore, duke qënë rreth 4 miliardë lekë më shumë se një vit më parë.
- Burimi me peshën më të madhe në të ardhurat vendore gjatë vitit 2023, është taksa e ndikimit mbi infrastrukturë me rreth 37.3% të të ardhurave të veta vendore. Pavarësisht se në nivel agregat ky burim është më i rëndësishmi për pushtetin vendor, **në nivel njësie rreth 72% e mbledh vetëm Bashkia Tiranë.**

- Taksat e pasurisë përbëjnë 17.7% të të ardhurave të veta vendore (6.2 miliardë lekë), ndërkohë që taksa mbi ndërtesën zë rreth **76% të totalit të të ardhurave nga taksat mbi pasurinë**. Taksa e ndërtesës në vitin 2023 është rritur me 200 milionë lekë (4%) ndaj një viti më parë, ndërsa taksa e tokës bujqësore është rritur me 33 milionë lekë (6%). Bashkia Tiranë realizon 47% të të ardhurave nga taksa e pasurisë në nivel kombëtar, ndërsa gjashtë bashkitë e mëdha (Durrës, Elbasan, Shkodër, Fier, Vlorë e Kamëz) realizojnë 22%.
- Kapaciteti dhe performanca fiskale e bashkive ndryshon shumë në varësi të madhësisë së popullsisë dhe kontekstit ekonomik. Bashkia Tiranë realizoi 56% të gjithë të ardhurave të veta vendore, dhe së bashku me gjashtë bashkitë më të mëdha sipas popullsisë – Durrës, Elbasan, Shkodër, Fier, Vlorë e Kamëz, realizuan tre të katërtat e të gjithë të ardhurave të veta vendore.
- Shpenzimet e pushtetit vendor për vitin 2023 janë rreth 10.2% e shpenzimeve të përgjithshme publike dhe 3.0 % e Prodhimit të Brendshëm Bruto. Krahasuar me trendin e një viti më parë, në raport me shpenzimet e përgjithshme publike, shpenzimet vendore janë rritur me 1.18% dhe po ashtu janë rritur me rreth 0.23%, ndaj PBB-së.
- **Të ardhurat më të larta për banor janë realizuar në bashkinë Himarë, me 43.8 mijë lekë për banor, e ndjekur nga Tirana (30.6 mijë lekë/banorë); Saranda (22.7 mijë lekë/banorë), Kamza (14.7 mijë lekë/banorë).** Bashkitë me mbi 100 mijë banorë kanë realizuar mesatarisht 7.3 mijë lekë të ardhura për banor (18% rritje); bashkitë e mesme me 50 – 100 mijë banorë kanë mbledhur mesatarisht 5 mijë lekë për banor (10% rritje nga 2022) dhe bashkitë e vogla kanë mbledhur gjithashtu mesatarisht 5 mijë lekë për banor (10% rritje). Bashkitë bregdetare Himarë dhe Sarandë kanë të ardhura shumë të larta për banor për shkak të të hyrave nga taksa e ndikimit në infrastrukturë.
- Shpenzimet për investime gjatë vitit 2023 zënë rreth **24.1% të totalit të shpenzimeve vendore**. Në raport me një vit më parë konstatohet që **shpenzimet për investime** kanë një **rritje me mbi 4.6 miliardë lekë ose 39%** dhe pesha relative e investimeve në strukturën buxhetore është rritur me 4%.
- Shpenzimet operative në vitin 2023, prej 19.4 miliardë lekë, zënë rreth **28.1% të totalit të shpenzimeve vendore**, në ulje të peshës relative në krahasim me vitin 2022, por **me një rritje të lehtë në vlerë nominale**.
- Zgjerimi i hapësirës fiskale për bashkitë gjatë vitit 2023 për shkak të rritjes së transfertave, taksave të ndara dhe të ardhurave të veta është fokusuar kryesisht në rritjen e shpenzimeve për paga (42% e rritjes) dhe investime (44% e rritjes).
- Pushteti vendor ka financuar në pjesën më të madhe të buxhetit funksionin e **“Çështjeve ekonomike”**; **“Shërbimeve të përgjithshme publike”** dhe **“Arsimit”**, përkatësisht në masën **21%; 20% dhe 19%**.

Disa nga objektivat për vitin 2024 për buxhetin vendor paraqiten si më poshtë:

- Rritja e kapacitetit të të ardhurave vendore me qëllim mundësimin e ofrimit cilësor të shërbimeve publike për qytetarët dhe me standarde të përcaktuara

Synimi kryesor është rritja e nivelit të autonomisë financiare të qeverisjes vendore, veçanërisht duke rritur nivelet e financimit të funksioneve vendore. Rritja e autonomisë fiskale është parashikuar të arrihet nëpërmjet (i) rritjes së të ardhurave vendore nga tatimi mbi pasurinë e paluajtshme, (ii) rritjes së pjesës së taksave të ndara, dhe (iii) gjenerimit të të ardhurave nga aktiviteti ekonomik i njësive të vetëqeverisjes vendore nëpërmjet përdorimit më eficient të aseteve vendore.

- Harmonizimi dhe unifikimi i procedurave për hartimin, zbatimin, raportimin, monitorimin e buxheteve të njësive të vetëqeverisjes vendore, konform standardeve ndërkombëtare;

Vijon puna për thellimin e metodologjive të menaxhimit financiar në nivel vendor në standardet më të mira ndërkombëtare. Përmirësimi i këtyre standardeve do të përfshijë të gjitha hapat e ciklit të menaxhimit financiar në nivel vendor, duke synuar në këtë mënyrë mbylljen e kuadrit nënligjor të MFP në pushtetin vendor.

- Konsolidimi fiskal dhe qëndrueshmëria e financave të pushtetit vendor gjatë vitit 2024, do të jenë tregues i rëndësishëm i forcimit të aftësisë së pushtetit vendor për ofrimin e shërbimeve publike.

Ruajtja e qëndrueshmërisë së transfertës së pakushtëzuar së përgjithshme dhe transfertës së pakushtëzuar sektoriale. Forcimi i disiplinës financiare për të parandaluar akumulimin e detyrimeve të prapambetura në të ardhmen, të cilat mund të kthehen në një rrezik serioz potencial për njësitet vendore, me ndikim negativ në ekonominë e vendit në tërësi.

- Ruajtja e standardeve ligjore për buxhetimin mbi bazë produkti, programi dhe funksioni në të gjitha njësitet vetëqeverisjes vendore;

Gjatë vitit 2024, njësitet e vetëqeverisjes vendore do të konsolidojnë ecurinë e përdorimit të standartit të unifikimit të shpenzimeve vendore jo vetëm në nivel llogarie ekonomike, por gjithashtu edhe në nivel produkti, programi e funksioni. Buxhetimi në nivel produkti, është një ndër objektivat e rëndësishme përmes së cilit synohet që njësitet e vetëqeverisjes vendore të kostojnë produktet e shërbimeve që ofrojnë për qytetarët. Gjatë vitit 2024 do të monitorohet pilotimi i 12 bashkive në përgatitjen e buxhetit me një numër të reduktuar programesh dhe detajimin deri në nivel produkti. Ministria e Financave do të vijojë punën për të konsoliduar buxhetimin në nivel produkti tek të gjitha njësitet e vetëqeverisjes vendore. Përfundimi i këtij procesi do të përmbyll një etapë të rëndësishme në rrugën drejt unifikimit në AFMIS të të gjithë njësive të vetëqeverisjes vendore.

- Implementimi i AFMIS në nivel vendor.

Në funksion të reformimit dhe modernizimit të financave publike dhe kryesisht atyre vendore, në strategjinë e Menaxhimit të Financave Publike është parashikuar që në vitet e ardhshme në sistemin IPSIS të përfshihen dhe njësitet e vetëqeverisjes vendore. Po ashtu strategjia e MFP-së parashikon që edhe AFMIS-i të jetë i zgjeruar dhe në njësitet e vetëqeverisjes vendore. Këto sisteme (IPSIS dhe AFMIS) që parashikohet

të jenë funksionale në vitet e ardhshme do të jenë një vlerë e shtuar e Menaxhimit Financiar Publik në nivel vendor. Ato do të unifikojnë të gjithë punën dhe operacionet financiare në të gjitha fazat dhe ciklet e menaxhimit financiar, do të mundësojnë një komunikim të efektshëm midis institucioneve dhe njësive qendrore me ato vendore dhe do të jenë një garanci më shumë për përdorimin e fondeve publike me efikasitet, ekonomi dhe efektshmëri.

- Monitorimi i mekanizmave që nxisin rritjen e transparencës dhe llogaridhënies së qeverisjes vendore në raport me komunitetin.

Një sfidë e rëndësishme për t'u thelluar në qeverisjen vendore mbetet rritja e transparencës dhe llogaridhënies përmes pjesëmarrjes qytetare në proceset e përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm dhe buxhetit vjetor. Në këto kushte, gjatë vitit 2024 Ministria e Financave do të synojë nxitjen e njësive të vetëqeverisjes vendore në ndërmarrjen e masave të nevojshme për përmirësimin e transparencës përmes publikimit dhe hartimit të buxhetit të qytetarit.

- Forcimi i rregullave dhe procedurave për menaxhimin e financave publike në nivel vendor duke siguruar më shumë disiplinë fiskale në menaxhimin e vështirësive financiare;

Në buxhetin e vitit 2024 do të synohet rritja e kapacitetit fiskal të njësive të vetëqeverisjes vendore dhe gjithashtu përmirësimi i shërbimeve publike të ofruara për qytetarët. Ministria e Financave në mënyrë të vazhdueshme do të ndjekë e monitorojë procesin e menaxhimit financiar në nivel vendor dhe përmes tij vlerësimin e treguesve të performacës së NJVQV-ve.

- Nxitja e zhvillimit ekonomik lokal dhe ulja e pabarazive midis njësive të vetëqeverisjes vendore.

Përmes politikave të reja të menaxhimit financiar, do të synohet ulja e diferencave ndërmjet njësive të vetëqeverisjes vendore dhe sigurimi i një financimi të qëndrueshëm në nivel vendor. Pushteti vendor si pjesë e rëndësishme e zhvillimit ekonomik kombëtar ka në thelb nxitjen e politikave të zhvillimit rajonal.




Analiza e treguesve fiskalë sipas njësive të vetëqeverisjes vendore




Treguesit e të ardhurave dhe shpenzimeve sipas njësive të vetëqeverisjes vendore

Bashkia Belsh

Grafiku 1 Të ardhurat sipas burimit 2023/2022




Grafiku 2 Shpenzimet sipas natyrës ekonomike 2023/2022




Bashkia Berat


Grafiku 3 Të ardhurat sipas burimit 2023/2022




Grafiku 4 Shpenzimet sipas natyrës ekonomike 2023/2022




Grafiku 5 Të ardhurat sipas burimit 2023/2022




Grafiku 6 Shpenzimet sipas natyrës ekonomike 2023/2022




Grafiku 7 Të ardhurat sipas burimit 2023/2022




Grafiku 8 Shpenzimet sipas natyrës ekonomike 2023/2022




Grafiku 9 Të ardhurat sipas burimit 2023/2022




Grafiku 10 Shpenzimet sipas natyrës ekonomike 2023/2022




Grafiku 11 Të ardhurat sipas burimit 2023/2022




Grafiku 12 Shpenzimet sipas natyrës ekonomike 2023/2022




Grafiku 13 Të ardhurat sipas burimit 2023/2022




Grafiku 14 Shpenzimet sipas natyrës ekonomike 2023/2022




Grafiku 15 Të ardhurat sipas burimit 2023/2022




Grafiku 16 Shpenzimet sipas natyrës ekonomike 2023/2022




Grafiku 17 Të ardhurat sipas burimit 2023/2022




Grafiku 18 Shpenzimet sipas natyrës ekonomike 2023/2022




Grafiku 19 Të ardhurat sipas burimit 2023/2022




Grafiku 20 Shpenzimet sipas natyrës ekonomike 2023/2022




Grafiku 21 Të ardhurat sipas burimit 2023/2022




Grafiku 22 Shpenzimet sipas natyrës ekonomike 2023/2022




Grafiku 23 Të ardhurat sipas burimit 2023/2022




Grafiku 24 Shpenzimet sipas natyrës ekonomike 2023/2022




Grafiku 25 Të ardhurat sipas burimit 2023/2022




Grafiku 26 Shpenzimet sipas natyrës ekonomike 2023/2022




Grafiku 27 Të ardhurat sipas burimit 2023/2022




Grafiku 28 Shpenzimet sipas natyrës ekonomike 2023/2022




Grafiku 29 Të ardhurat sipas burimit 2023/2022




Grafiku 30 Shpenzimet sipas natyrës ekonomike 2023/2022




Grafiku 31 Të ardhurat sipas burimit 2023/2022




Grafiku 32 Shpenzimet sipas natyrës ekonomike 2023/2022




Grafiku 33 Të ardhurat sipas burimit 2023/2022




Grafiku 34 Shpenzimet sipas natyrës ekonomike 2023/2022




Grafiku 35 Të ardhurat sipas burimit 2023/2022




Grafiku 36 Shpenzimet sipas natyrës ekonomike 2023/2022




Grafiku 37 Të ardhurat sipas burimit 2023/2022




Grafiku 38 Shpenzimet sipas natyrës ekonomike 2023/2022




Grafiku 39 Të ardhurat sipas burimit 2023/2022




Grafiku 40 Shpenzimet sipas natyrës ekonomike 2023/2022




Grafiku 41 Të ardhurat sipas burimit 2023/2022




Grafiku 42 Shpenzimet sipas natyrës ekonomike 2023/2022




Grafiku 43 Të ardhurat sipas burimit 2023/2022




Grafiku 44 Shpenzimet sipas natyrës ekonomike 2023/2022




Grafiku 45 Të ardhurat sipas burimit 2023/2022




Grafiku 46 Shpenzimet sipas natyrës ekonomike 2023/2022




Grafiku 47 Të ardhurat sipas burimit 2023/2022




Grafiku 48 Shpenzimet sipas natyrës ekonomike 2023/2022




Grafiku 49 Të ardhurat sipas burimit 2023/2022




Grafiku 50 Shpenzimet sipas natyrës ekonomike 2023/2022




Grafiku 51 Të ardhurat sipas burimit 2023/2022




Grafiku 52 Shpenzimet sipas natyrës ekonomike 2023/2022




Grafiku 53 Të ardhurat sipas burimit 2023/2022




Grafiku 54 Shpenzimet sipas natyrës ekonomike 2023/2022




Grafiku 55 Të ardhurat sipas burimit 2023/2022




Grafiku 56 Shpenzimet sipas natyrës ekonomike 2023/2022




Grafiku 57 Të ardhurat sipas burimit 2023/2022




Grafiku 58 Shpenzimet sipas natyrës ekonomike 2023/2022




Grafiku 59 Të ardhurat sipas burimit 2023/2022




Grafiku 60 Shpenzimet sipas natyrës ekonomike 2023/2022




Grafiku 61 Të ardhurat sipas burimit 2023/2022




Grafiku 62 Shpenzimet sipas natyrës ekonomike 2023/2022




Grafiku 63 Të ardhurat sipas burimit 2023/2022




Grafiku 64 Shpenzimet sipas natyrës ekonomike 2023/2022




Grafiku 65 Të ardhurat sipas burimit 2023/2022




Grafiku 66 Shpenzimet sipas natyrës ekonomike 2023/2022




Grafiku 67 Të ardhurat sipas burimit 2023/2022




Grafiku 68 Shpenzimet sipas natyrës ekonomike 2023/2022




Grafiku 69 Të ardhurat sipas burimit 2023/2022




Grafiku 70 Shpenzimet sipas natyrës ekonomike 2023/2022




Grafiku 71 Të ardhurat sipas burimit 2023/2022




Grafiku 72 Shpenzimet sipas natyrës ekonomike 2023/2022




Grafiku 73 Të ardhurat sipas burimit 2023/2022




Grafiku 74 Shpenzimet sipas natyrës ekonomike 2023/2022




Grafiku 75 Të ardhurat sipas burimit 2023/2022




Grafiku 76 Shpenzimet sipas natyrës ekonomike 2023/2022




Grafiku 77 Të ardhurat sipas burimit 2023/2022




Grafiku 78 Shpenzimet sipas natyrës ekonomike 2023/2022




Grafiku 79 Të ardhurat sipas burimit 2023/2022




Grafiku 80 Shpenzimet sipas natyrës ekonomike 2023/2022




Grafiku 81 Të ardhurat sipas burimit 2023/2022




Grafiku 82 Shpenzimet sipas natyrës ekonomike 2023/2022




Grafiku 83 Të ardhurat sipas burimit 2023/2022




Grafiku 84 Shpenzimet sipas natyrës ekonomike 2023/2022




Grafiku 85 Të ardhurat sipas burimit 2023/2022




Grafiku 86 Shpenzimet sipas natyrës ekonomike 2023/2022




Grafiku 87 Të ardhurat sipas burimit 2023/2022




Grafiku 88 Shpenzimet sipas natyrës ekonomike 2023/2022




Grafiku 89 Të ardhurat sipas burimit 2023/2022




Grafiku 90 Shpenzimet sipas natyrës ekonomike 2023/2022




Grafiku 91 Të ardhurat sipas burimit 2023/2022




Grafiku 92 Shpenzimet sipas natyrës ekonomike 2023/2022




Grafiku 93 Të ardhurat sipas burimit 2023/2022




Grafiku 94 Shpenzimet sipas natyrës ekonomike 2023/2022




Grafiku 95 Të ardhurat sipas burimit 2023/2022




Grafiku 96 Shpenzimet sipas natyrës ekonomike 2023/2022




Grafiku 97 Të ardhurat sipas burimit 2023/2022




Grafiku 98 Shpenzimet sipas natyrës ekonomike 2023/2022




Grafiku 99 Të ardhurat sipas burimit 2023/2022




Grafiku 100 Shpenzimet sipas natyrës ekonomike 2023/2022




Grafiku 101 Të ardhurat sipas burimit 2023/2022




Grafiku 102 Shpenzimet sipas natyrës ekonomike 2023/2022




Grafiku 103 Të ardhurat sipas burimit 2023/2022




Grafiku 104 Shpenzimet sipas natyrës ekonomike 2023/2022




Grafiku 105 Të ardhurat sipas burimit 2023/2022




Grafiku 106 Shpenzimet sipas natyrës ekonomike 2023/2022




Grafiku 107 Të ardhurat sipas burimit 2023/2022




Grafiku 108 Shpenzimet sipas natyrës ekonomike 2023/2022




Grafiku 109 Të ardhurat sipas burimit 2023/2022




Grafiku 110 Shpenzimet sipas natyrës ekonomike 2023/2022




Grafiku 111 Të ardhurat sipas burimit 2023/2022




Grafiku 112 Shpenzimet sipas natyrës ekonomike 2023/2022




Grafiku 113 Të ardhurat sipas burimit 2023/2022




Grafiku 114 Shpenzimet sipas natyrës ekonomike 2023/2022




Grafiku 115 Të ardhurat sipas burimit 2023/2022




Grafiku 116 Shpenzimet sipas natyrës ekonomike 2023/2022




Grafiku 117 Të ardhurat sipas burimit 2023/2022




Grafiku 118 Shpenzimet sipas natyrës ekonomike 2023/2022




Grafiku 119 Të ardhurat sipas burimit 2023/2022




Grafiku 120 Shpenzimet sipas natyrës ekonomike 2023/2022



Grafiku 121 Të ardhurat sipas burimit 2023/2022




Grafiku 122 Shpenzimet sipas natyrës ekonomike 2023/2022



Analiza e buxheteve sipas Këshillave të Qarqeve


Këshilli i Qarkut Berat

Grafiku 123 Shpenzimet sipas natyrës ekonomike 2023/2022




Këshilli i Qarkut Dibër

Grafiku 124 Shpenzimet sipas natyrës ekonomike 2023/2022




Këshilli i Qarkut Durrës

Grafiku 125 Shpenzimet sipas natyrës ekonomike 2023/2022




Këshilli i Qarkut Elbasan

Grafiku 126 Shpenzimet sipas natyrës ekonomike 2023/2022




Këshilli i Qarkut Fier

Grafiku 127 Shpenzimet sipas natyrës ekonomike 2023/2022




Këshilli i Qarkut Gjirokastrë

Grafiku 128 Shpenzimet sipas natyrës ekonomike 2023/2022




Këshilli i Qarkut Kukës

Grafiku 129 Shpenzimet sipas natyrës ekonomike 2023/2022




Këshilli i Qarkut Lezhë

Grafiku 130 Shpenzimet sipas natyrës ekonomike 2023/2022




Këshilli i Qarkut Shkodër

Grafiku 131 Shpenzimet sipas natyrës ekonomike 2023/2022




Këshilli i Qarkut Tiranë

Grafiku 132 Shpenzimet sipas natyrës ekonomike 2023/2022



Këshilli i Qarkut Vlorë

Grafiku 133 Shpenzimet sipas natyrës ekonomike 2023/2022



Këshilli i Qarkut Korçë

Grafiku 134 Shpenzimet sipas natyrës ekonomike 2023/2022

